# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7739 E shtunë 15 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Fjalimi i Ditës

Nga GENT SEJKO

## Shërbim bankar edhe në zonat rurale



Të nderuar pjesëmarrës e kolegë, është një kënaqësi e veçantë të hap takimin e sotëm, i cili vjen pas një viti intensiv bashkërendimi përpjekjesh midis institucioneve... Vijon në faqen 21

Opinioni i Ditës

Nga BERAT BUZHALA

## Frika ime nga ushtria



Rrëfimet e burrave më të vjetër të fisit për ushtrinë e Jugosllavisë, shërbim ky i detyrueshëm, i dëgjoja me një kureshtje të maces, por edhe më frikësonin tej mase... Vijon në faqen 20

LISTA E DYTE/ TRASHEGIMTARET QE PERFITOJNE KESTIN E TRETE TE PARAVE

# 2800 TE PERNDJEKURIT QE MARRIN DEMSHPERBLIMIN

Ministria e Financae publikon emrat e përfituesve. Dokumentet që duhen dorëzuar brenda tre muajve, kopja e kartës së identitetit dhe llogaria bankare aktive



*(Në foto)* Ish-të përndjekur politikë, vjet gjatë një proteste, ku kanë kërkuar dëmshpërblimin për vitet e burgut

Në faqet 8-9



Protesta, sot bashkohen banorët e "Astirit"

## Studentët, në shi para Kryeministrisë. Rama, replika me rektorin Mynyr Koni

Kryeministri shan drejtuesin e UT-së: I pafytyrë, burrë rrëshqanor, veshëgjatë

Në mbledhjen e dy ditëve më parë me rektorë e dekanë, kryeministri i vendit, Edi Rama ka folur me tone të ashpra ndaj tyre e i ka akuzuar si fajtorë për gjendjen që solli protestën e mijëra studentëve. Në kundërpërgjigje të akuzave të kreut të qeverisë, rektori i Universitetit të Tiranës, Mynyr Koni thekson se Rama nuk njeh...

Në faqet 2-3

SOT MBLIDHET KUVENDI

### Shpallet lista, 350 kandidatët për Këshillin Kombëtar të Partisë Demokratike

Në faqen 5

SHKOZET

### Maskat grabisin furgonin me 7.5 mln lekë të Drejtorisë së Patentave

Në faqen 7

SHPERTHIMI

### Tritol gruas së biznesmenit që u vra 3 vite më parë në Vlorë

Në faqen 7

KONSENSUS NE KUVEND

### Ditë historike për Kosovën, FSK-ja transformohet në ushtri të vërtetë

Në faqen 19

KOMPENSIMI




### Pronarët në Tiranë dhe në rrethe që ndajnë 6 milionë euro, lista e re

Në faqet 10-11

BLUE TOOTH Mbyll hallet në Shqipëri, Elvana Gjata jep datat e turit në SHBA

## Soni Malaj, rikthim me këngë "autobiografike"

*Këngëtarja garon në "Fest '57": Mesazh për ato që s'bëjnë kompromise*

Nga PAMELA ALIAJ

Është rikthyer në skenë një nga këngëtaret më të dashura të publikut. Më një këngë në të cilën shfaqet më e fortë dhe më e plotësuar se kurrë në çdo dimension të jetës së saj. Po flasim pikërisht për Soni Malaj, këngëtarja






bukuroshe, e cila është një prej protagonisteve kryesore në Festivalin e 57-të të RTSH-së. "Më e fortë" titullohet kënga me të cilën ajo do të konkurrojë këtë vit dhe ende pa nisur festivali, ajo ka arritur të ngrejë peshë zemrat e audiencës...

Suplement

# PROTESTA E STUDENTEVE
## PERPLASJET

Mynyr Koni: Protesta e studentëve shpreh demokraci. Kreu i qeverisë nuk njeh ligjin

# Luftë e ashpër mes kryeministrit e rektorit të Universitetit të Tiranës

## *Rama, Konit: E mëshiroj pafytyrësinë tuaj*

Në mbledhjen e dy ditëve më parë, me rektorë e dekanë, kryeministri i vendit Edi Rama ka folur me tone të ashpra ndaj tyre e i ka akuzuar si fajtorë për gjendjen që solli protestën e mijëra studentëve. Në kundërpërgjigje të akuzave të kreut të qeverisë, rektori i Universitetit të Tiranës, Mynyr Koni thekson se Rama nuk njeh ligjin e arsimit të lartë. "Të mundohesh të ndryshosh rrjedhën e gjërave, të mundohesh të gjesh dhe të bësh "fajtor" pa faj, nuk është gjë tjetër veçse një përpjekje e dështuar që tregon vetëm frikë dhe asgjë tjetër. Zoti Kryeminister, në asnjë ditë të punës time si Rektor i Universitetit të Tiranës nuk jam "arratisur" nga përgjegjësia, por përkundrazi. Në mënyrë të vazhdueshme, kam paraqitur problematikat (që Ju vetëm tani po i pranoni se ekzistojnë) në të gjitha institucionet e shtetit shqiptar, përfshirë edhe Ju. Akuzat që ju bëni, tregojnë shumë qartë se Ju nuk e njihni ligjin e arsimit të lartë 80/2015",-thotë rektori në një deklaratë të bërë në faqen zyrtare të UT-së. Ky i fundit, gjithashtu, thekson se nuk është bërë asnjë kërkesë nga senati akademik i këtij universiteti për vendosjen e tarifës për provimet e mbartura si dhe akuzon kryeministrin për presion intimidim e shantazh. "Të njëjtën gjë bëni edhe me çështjen e tarifës së provimeve të mbartura të studentëve, për të cilën, Senati Akademik i UT, ka deklaruar se nuk ka bërë asnjë kërkesë për vendosjen e saj. Në çdo rast, Ju ushtroni presion, intimidim, ironizoni dhe shantazhoni, jo vetëm në mënyrë të drejtëpërdrejtë por edhe nëpërmjet mediave që janë pranë qeverisë, duke mos i dhënë mundësinë askujt, në rastin konkret mua, të shprehem dhe të them të vërtetën se çfarë realisht po ndodh në Universitetin e Tiranës",-nënvizon Koni. Ky i fundit shton se në UT, ka patur probleme të brendshme, që fatkeqësisht kanë gjetur mbështetjen nga institucionet më të larta të shtetit shqiptar. "Ju po deklaroni sot, se duhet të shkarkohen anëtarët e Bordit të Administrimit, kurse unë, në mënyrë të vazhdueshme i kam kërkuar Ministres së Arsimit, të marrë masat e nevojshme për çfarë Ju keni konstatuar sot, si një dështim të funksionimit edhe të Bordit të Aministrimit të Universitetit të Tiranës. Nëse për Kryeministrin dhe qeverinë që ai drejton, protesta e studentëveështe një shuplakë, për mua është një shprehje e lirisë dhe demokracisë, dhe si e tillë është një fitore",-thekson rektori në deklaratën e tij.

**REAGIMI I KRYEMINISTRIT**

Në një kohë që studentët po përballojnë protestën mes të ftohtit, duket se lufta mes Universitetit të Tiranës dhe kreut të qeverisë vazhdon të jetë gjithmonë e më e ashpër. Pas deklaratës së rektorit të UT-së, ka ardhë reagimi nga kryeministri Rama i cili nëpërmjet një postimi në rrjetin social Twitter, i është përgjigjur ashpër dhe madje me epitete fyese Mynyr Konit duke e quajtur të pafytyrë. "Zoti Rektor i UT, unë e mëshiroj pafytyrësinë Tuaj të dyfytyrtë dhe reagimin Tuaj tipik për burrat rrëshqanorë! Sidoqoftë, unë shumë shpejt do të jem auditor më auditor, ku shpresoj të keni kurajon të m'i thoni në sy veshëgjatësitë e shkruara në reagimin Tuaj që flet vetë për Ju",-shkruan Rama.



Faksimile e reagimit të Ramës

Faksimile e reagimit të Konit

**"BURRË RRËSHQANOR"**
"Zoti rektor i UT, unë e mëshiroj pafytyrësinë tuaj të dyfytyrtë dhe reagimin tuaj tipik për burrat rrëshqanorë! Sidoqoftë, unë shumë shpejt do të jem auditor më auditor, ku shpresoj të keni kurajon të m'i thoni në sy veshëgjatësitë e shkruara në reagimin tuaj që flet vetë për tu", - shkruan Rama.



Protesta e studentëve te Kryeministria

**"JU SHANTAZHONI"**
"Në çdo rast, ju ushtroni presion, intimidoni, ironizoni dhe shantazhoni, jo vetëm në mënyrë të drejtëpërdrejtë, por edhe nëpërmjet mediave që janë pranë qeverisë, duke mos i dhënë mundësinë askujt, në rastin konkret mua, të shprehem dhe të them të vërtetën se çfarë realisht po ndodh në Universitetin e Tiranës", - nënvizon Koni.

**"SHPREHJA E LIRISË"**
Nëse për kryeministrin dhe qeverinë që ai drejton, protesta e studentëve është një shuplakë, për mua është një shprehje e lirisë dhe demokracisë, dhe si e tillë është një fitore", - thekson rektori në deklaratën e tij.

## Taulant Muka zbardh plagjiaturën e vajzës së Dhori Kules, pedagoge tek Ekonomiku

Në vijim të denoncimeve të plagjiaturave në doktoratura, ish- zv/ministri i Arsimit, Taulant Muka ka zbuluar dje se vajza e Dhori Kules, Ditjona, njëkohësisht pedagoge në Fakultetin Ekonomik të UT ka bërë plagjiaturë në punimin e saj të Doktoraturës. Sipas Mukës, hasen kopjime pa cituar burimin origjinal nga tekste të mëparshme në shqip e shton se rreth 1/3 e Doktoraturës së Kules është e kopjuar, ç'ka e bën atë një nga plagjiaturat më të mëdha që ai së bashku me Vladimir Kolën kanë zbuluar dhe publikuar. "Sharlatanët dekan/rektor, nga padija dhe babëzia, shkatërrojnë të ardhmen e të gjithëve, edhe të fëmijëve të tyre! Ata nuk e njohin meritokracinë dhe vlerën akademike! Vladimir Kola zbulon nëpërmjet internetit, plagjiaturën e Tezës së Doktoraturës së zonjës Ditjona Kule me titull "Ndikimi i Arsimit të Lartë në Rritjen Ekonomike: Rasti i Shqipërisë"",-thekson ish zv.ministri i Arsimit. Ky i fundit shton se në këtë punim doktorature ka edhe kopjime nga dokumente në gjuhën shqipe. "Është për t'u theksuar se në këtë Tezë Doktorature gjeni kopjime, jo vetëm në anglisht të përkthyera në shqip, por gjeni edhe tekse të kopjuara nga dokumente në gjuhën shqipe, pa u cituar burimi orgjinal. Gjithashtu, edhe përqindja e kopjuar, në këtë Tezë Doktorature, është shumë e lartë. Me sa kam llogaritur unë, është të paktën 1/3 e tekstit total të Tezës",-thotë Muka.



DOKTORATURA DITJONA KULE ------------- PLAGJIATURE

| BEXHETI dhe MUSTAFI, shkurt 2015 | DITJONA KULE, qershor 2015 |
|---|---|
| ZBULIMI VLADIMIR KOLA | PUBLIKIMI TAULANT MUKA |
| ...t of authors that estimate the link between public spending on education and economic growth using ...ometrics models that depend from the data that are used. Nkiru Patricia and Daniel Izuchukwu used ...n model to estimate the variables, some others like, Davidson and Mackinnon (1993), Engert and ...) and Verbeck (2000) states that vector error correction models VECM is a good tool for government ... economic forecasting model. | Ka shumë autorë që vlerësojnë marrëdhënien ndërmjet shpenzimeve në ars... rritjes ekonomike duke përdorur modele të ndryshme ekonometrike për... dhënave të ndryshme. Nkiru Patricia dhe Daniel Izuchukwu përdorën mo... regresiount log për të vlerësuar variablat por t ë tjerë si Davidson dhe Mac... (1993), Engert dhe Hendry (1998) dhe Verbeck (2000) pohojnë se Modelet ... janë mjaft të mira për tu përdorur me qëllim që të tregohet ndikimi i arsimit ... në rritjen ekonomike. |
| ...nsideration that these models requires more data, which are not available in transition countries like ...o examine the effect of public expenditure in Education on economic growth in Macedonia, we adopt ...ic Regression Model that test how much public funding of education, separately in three categories or ...rect expenditures in education, capital expenditures in education and indirect expenditures on education ...mpact on economic growth. | Duke marrë në konsideratë se këto modele kërkojnë një databazë të ma... dhënash të cilat nuk janë të disponueshme për vendet në tranzicion si... Shqipëria, për të treguar ndikimin që ka arsimi i lartë në rritjen ekonomik... përdorur modelin e regresiount DLog. Kemi përdorur analizën regresive OLS... studiuar dhe analizuar ndikimin që ka arsimi i lartë në rritjen ekonomike në... variablave të marra në shqyrtim. |

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**,** ***Marketingu*:** Cel:0682074415***-email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



**VASILI**
Përmes një statusi në rrjetin social "Facebook", kreu i grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Petrit Vasili u bëri thirrje studentëve për rrëzimin e Ramës, sepse çdo veprim tjetër është një frymë e harxhuar kot. "Mos harxhoni frymë me një kryeministër qen të karriges, rrëzojeni", tha Vasili.

## Studentët e rretheve marshojnë në këmbë drejt Tiranës

Me protestën e studentëve të Tiranës janë solidarizuar dje edhe bashkëmoshatarët e tyre nga universitetet e rretheve. Që në orët e para të ditës së djeshme ata kanë bojkotuar sërish mësimin dhe kanë nisur marshimin nga qytete të ndryshme drejt Tiranës. Një grup i vogël studentësh të Elbasanit kanë sfiduar shiun dhe janë nisur drejt kryeqytetit, ndërsa një grup studentësh të tjerë u mblodhën para universitetit "Aleksandër Xhuvani", ndërsa bënë thirrje për pjesëmarrje masive në protestë. Po ashtu, studentët e Korçës kanë bojkotuar mbledhjen e senatit dhe mësimin në auditorë dhe kanë dalë në protestë duke u solidarizuar me moshatarët e tyre në Tiranë. Po ashtu studentë, gjimnazistë dhe të rinj nga Lezha dhe Shkodra janë nisur në këmbë drejt Tiranës, ku do t'i bashkohen protestës para Kryeministrisë. Protestës i janë bashkuar sërish dje edhe studentët e Gjirokastrës, të cilët mbështetën si të drejta kërkesat e paraqitura.

## Devolli e Shkodra në protestë, u bllokua qarkullimi i mjeteve

Qindra qytetarë të Devollit kanë dolën sërish dje në protestë, duke bllokuar aksin kryesor që lidh qytetin e Bilishtit me Korçën. Në protestë merrnin pjesë qytetarë, biznese të vogla dhe fermerë, të cilët kërkojnë uljen e çmimit të naftës, të energjisë elektrike si dhe ndihmë për fermerët e njohur të kësaj zone. Qytetaret e Devollit u shprehën të vendosur në protestën e tyre, ndërsa me ta u solidarizuan edhe shoferët e makinave. Protestë u zhvillua edhe në Shkodër, ku pavarësisht motit me reshje shiu, qytetarët vijuan për të katërtën ditë me radhë duke kundërshtuar kushtet e vështira ekonomike, rritjen e çmimit të naftës dhe rritje e taksave.

Dialogu me studentët, mazhoranca është e gatshme të thërrasë parlamentin

# Dita e 10 e protestës, studentët-Ramës: Mblidh Kuvendin

## *Sot, protestë mbarëkombëtare*

Ndonëse me një numër më të reduktuar për shkak edhe të kushteve atmosferike, studentët kanë vazhduar edhe dje për të dhjetën ditë me radhë qëndresën para Kryeministrisë, duke kërkuar plotësimin pa kushte të 8 kërkesave të tyre. Duke sfiduar shiun dhe të ftohtin, një grup studentësh e kanë gdhirë para Kryeministrisë, ndërsa më pas u janë bashkuar edhe shumë kolegë të tyre, të cilët kanë marshuar nga fakultetet e tyre drejt bulevardit "Dëshmorët e Kombit". Protestës së Tiranës iu bashkuan edhe studentë të tjerë të ardhur nga rrethet. Disa prej tyre nisën në mënyrë simbolike marshimet në këmbë, për të mbërritur në Tiranë në mbështetje të bashkëmoshatarëve të tyre. Ata hodhën parulla kundër qeverisë, duke kërkuar nga kryeministri që të lërë lojën e fjalëve dhe të plotësojë sa më parë kërkesat e tyre. Ndërsa u shprehën të vendosur për ta çuar deri në fund betejën për një arsim të lartë më të mirë në Shqipëri, studentët i kërkuan Ramës që të mbledhë sa më parë Kuvendin dhe të miratojë 8 pikat që ata kanë shtruar për zgjidhje. "Kemi 10 ditë që jemi këtu, po protestojmë dhe që nuk na dëgjoni, prandaj zoti kryeministër, të gjithë ne studentët, ju bëjmë thirrje që deri në orën 16:00 të thërrisni për seancë të jashtëzakonshme parlamentin. Jemi të vendosur për t'i shkuar deri në fund", tha njëri prej studentëve organizatorë të protestës, duke i vendosur një tjetër ultimatum qeverisë për miratimin e kërkesave. Por ndërkohë kryeministri Rama duke marrë shkas nga kjo kërkesë nëpërmjet një postimi në "Instagram", përsëriti thirrjen për dialog me studentët. Më parë po gjatë ditës së djeshme ai nëpërmjet një tjetër postimi në rrjetet sociale u shprehu studentëve gatishmërinë që të plotësonte të 8 pikat që ata kanë ngritur për zgjidhje, por për të arritur këtë, ai kërkoi sërish nga studentët që të ulen në bisedime për të arritur një marrëveshje. Po ashtu, kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla nisur nga kërkesa e studentëve për të mbledhur Kuvendin, shprehu gatishmërinë e mazhorancës për ta plotësuar këtë kërkesë të re të studentëve, por vetëm me qëllim që aty të diskutojë kryeministri me studentët. "Po! Parlamenti mund të mblidhet nesër me kryeministrin dhe studentët, të cilët është koha të ulen e të mbyllin Paktin për Universitetin duke nisur nga miratimi i 8 pikave. Uroj që studentët ta bëjmë këtë pa humbur kohë dhe të kthehen në shtëpi me suksesin e protestës së tyre", shkroi Balla. Ndërkohë që burime nga mazhoranca bënë të ditur dje në mbrëmje se administratës së Kuvendit i ishte kërkuar që të qëndronte në gatishmëri, duke lënë të hapur mundësinë e thirrjes së Kuvendit në një seancë të jashtëzakonshme. Studentët kanë paralajmëruar vijimin e protestës edhe gjatë ditës së sotme, ndërsa u bënë thirrje edhe qytetarëve që t'i bashkohen betejës së tyre. Ata deklaruan se gjatë ditës së sotme do të mbahet një protestë mbarëkombëtare.


Protesta e studentëve

**BALLA**
"Po! Parlamenti mund të mblidhet nesër me kryeministrin dhe studentët, të cilët është koha të ulen e të mbyllin Paktin për Universitetin duke nisur nga miratimi i 8 pikave. Uroj që studentët ta bëjnë këtë pa humbur kohë dhe të kthehen në shtëpi me suksesin e protestës së tyre".

## Banorët e "Astirit" do i bashkohen sot protestës së studentëve

Paralelisht me studentët, edhe banorët e "Astirit" që preken nga projekti i zgjerimit të Unazës së Madhe kanë vijuar dje në mbrëmje protestën e tyre, e cila ka shënuar ditën e 41-të. Ata janë mbledhur sërish në rrugë dhe të veshur me jelekët portokalli janë shprehur të vendosur që të mos lejojnë ARSH-në dhe Bashkinë e Tiranës që të vijojë me projektin e kësaj rruge pa dëmshpërblyer çdo ndërtesë që preket. Protestës së tyre iu bashkuan edhe dy deputetët e opozitës, ai i PD-së, Klevis Balliu dhe ai i LSI-së, Endrit Brahimllari, të cilët theksuan edhe një herë se nuk do të lejojnë që qeveria t'u prishë shtëpitë banorëve të "Astirit". "Zona e Unazës së Re është një zonë krimi se është vërtetuar që është bërë një vjedhje dhe nuk mund të ketë asnjë lloj punimi, asnjë lloj hapi nga asnjë kompani, as nga bashkia, as nga qeveria pasi çdo punim i mëtejshëm përderisa nuk është nxjerrë autori i këtij krimi, do të shërbente vetëm për prishjen e provave", tha Klevis Balliu. "Sot mbahen në burg tre djem që protestuan për pronën e tyre dhe nuk shkon në burg Gjiknuri, Qendro dhe Edi Rama", u shpreh deputeti i LSI-së, Brahimllari. Banorët e "Astirit" kanë bërë të ditur gjithashtu se sot do t'u bashkohen protestës së studentëve, pas apelit të tyre për protestë mbarëkombëtare. "E duam Shqipërinë pa Edi Ramën, sepse ai është një kriminel, hajdut dhe mashtrues. Jemi me studentët, studentët janë bijtë tanë. Nesër në orën 9 të gjithë bashkuar, të gjithë të bashkuar jemi të fituar", tha një nga banorët gjatë protestës, duke zbuluar se do t'i bashkohen kauzës së studenteve.



Protesta e banorëve të "Astirit"

# VETINGU NË POLITIKË

## MIRATIMI

"Venecia" miraton draft-opinionin final për Shqipërinë: Propozimet, me probleme

# Vetingu në politikë, Komisioni i Venecias: Vendosni në Kuvend

## "Verifikimi, e paqartë se kush do të jetë përgjegjës"

Valentina Madani

Komisioni i Venecias miratoi dje draft opinionin për Shqipërinë. Sipas draftit final, theksohet se "Komisioni i Venecias shpreh shqetësimin se mungesa e qartësisë ligjore dhe sigurisë lidhur me fushëveprimin dhe zbatimin e procedurës së propozuar të verifikimit mund të çojë në implikime të rënda". Sipas Komisionit të Venecias, "në varësi të situatës politike, një kufizim për një rrethanë të caktuar, që mund të jetë i nevojshëm për një shtet, mund të mos aplikohet për një shtet tjetër". Në draftin final të miratuar gjatë paradites së djeshme, "Venecia" konstaton se propozimi kushtetues për verifikimin e politikanëve, edhe pse me synim legjitim, nuk siguron zgjidhje dhe masa mbrojtëse dhe mund të çojë në abuzim me pushtetin, siç thuhet në njoftimin zyrtar të Këshillit të Europës, pjesë e të cilit është komisioni i Venecias. "Amendamentet kushtetuese për verifikimin e politikanëve në Shqipëri, përfshirë vlerësimin e marrëdhënieve të tyre me krimin e organizuar nuk sigurojnë zgjidhje dhe masa mbrojtëse të përshtatshme për një proces të tillë të ndjeshëm dhe mund të çojnë lehtësisht në abuzim të pushtetit. Duke pranuar synimin legjitim për të hequr kriminelët dhe ndikimin e tyre te qeverisja dhe jeta politike, Komisioni i Venecias shpreh shqetësimin se mungesa e qartësisë ligjore dhe sigurisë lidhur me fushëveprimin dhe zbatimin e procedurës së propozuar të verifikimit mund të çojë në implikime të rënda për të drejtat e atyre që bëhen subjekt", thuhet në draft-opinionin. Opinioni vë në dukje se nuk është e qartë se kush do të jetë përgjegjës për procesin apo për sa kohë do të jetë skualifikimi i politikanëve të lidhur me krimin. "Nuk është e qartë se kush do të jetë përgjegjës për verifikimin dhe nëse kjo do të bëhet nga një organ gjyqësor ose i pavarur. Nuk ka qartësi ligjore nëse skualifikimi duhet të jetë i përhershëm ose i kufizuar dhe nuk ka garanci për të siguruar që procesi të mos përdoret në mënyrë të njëanshme politike ose arbitrare",-thuhet më tej në draft. Jo vetëm për mënyrën sesi do të kryhet ky proces, por në opinionin final "Venecia" vëren paqartësi edhe tek çështja e kontakteve të padëshirue-shme. Komisioni vëren se: "Projektligji, gjithashtu, nuk arrin të përcaktojë disa elementë kryesorë, si: çfarë nënkuptohet me kontakt me persona të caktuar; çka nënkuptohet duke u përfshirë në krimin e organizuar; dhe çfarë nënkuptohet duke u përfshirë në rrethin e subjekteve që kanë kontakte me personat". Lidhur me zyrtarët e zgjedhur, Komisioni i Venecias gjen se propozimi është në kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, sepse shqyrtimi bazuar në atë nëse dikush ka kontakte me personat e përfshirë në krimin e organizuar mund të përdoret lehtë për kufizimin e të drejtës për zgjedhje të lira, pavarësisht nga natyra e kontakteve. Komisioni vë në diskutim vlerën e shtuar ligjore të amendamenteve. "Paqartësitë rreth fushëveprimit dhe zbatimit të tij e bëjnë të vështirë garantimin e të drejtave sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Duke pasur parasysh dispozitat ekzistuese kushtetuese, ligjet e tjera dhe me mekanizmat e tjerë demokratikë në dispozicion, Komisioni i Venecias beson se vlera e shtuar ligjore e amendamenteve të propozuara është e diskutueshme",-thuhet në opinion.


Komisioni i Venecias

**MBËSHTETJA**

"Venecia" ofrohet e gatshme të sigurojë ndihmë të mëtejshme, por u kujton palëve se vendimi për amendimet kushtetuese lidhur me vetingun në politikë duhet të merret në parlament nëpërmjet dialogut midis të gjitha forcave politike dhe shoqërisë në përgjithësi, në interes të demokracisë shqiptare.


Kuvendi Kombëtar i PD-së

**AMENDAMENTET**

Në opinionin final për Shqipërinë, komisioni përfshiu edhe disa amendamente që gjetën mbështetjen e opozitës, ku saktëson se shtetet kanë të drejtë të kufizojnë mundësinë për t'u zgjedhur. Në varësi të situatës politike, një kufizim për një rrethanë të caktuar, që mund të jetë i nevojshëm për një shtet, mund të mos aplikohet për një tjetër shtet.

## 'Venecia' përplas mazhorancën me opozitën

## Rama: Ti s'vë mend. Basha: Hajduti psiqik nuk kupton as shqipen



Opinioni final i Komisionit të Venecias lidhur me amendamentet e propozuara nga opozita shqiptare për vetingun në politikë, përplasi dje kryeministrin Edi Rama me kreun e opozitës, Lulzim Basha. Njoftimi për media i Komisionit të Venecias njeh qëllimin legjitim të propozimeve të PD-së, të cilat synojnë heqjen e shkelësve të ligjit apo influencës së tyre nga qeveria dhe jeta politike, por shpreh shqetësim se mungesa e qartësisë ligjore sa i përket implementimit të vetingut të propozuar mund të çojë në komplikime të rënda sa i përket të drejtës së atyre që do të jenë subjekt i këtij procesi. Rama tha se "Gjojavetingu" i PD u mbyt në ujin e Venecias. "Eh Artist, s' më vjen mirë për ty, po ti s've mend! Vate e u mbyt në ujin e Venecias edhe Gjojavetingu yt, një nga ato manovrat e tua në xunkth që e kanë bërë PD aq shumë joserioze në sytë e njerëzve, sa jeni hedhur në ilegalitet për të penguar Dialogun mes studentëve e qeverisë",-shkroi Rama në 'Twitter'. Kryedemokrati Basha në krahun tjetër iu kundërpërgjigj Ramës duke e quajtur 'hajdut psikik', që ka 9 ditë që nuk kupton as shqipen, pale pastaj anglishten. "Hajduti psiqik ka 9 ditë që nuk kupton as shqipen, pale pastaj anglishten! Mirënjohje Komisionit të Venecias që hapi dritën jeshile për vetingun e politikanëve. Asgjë nuk e shpëton hajdutin psiqik nga lidhjet me krimin! Koha kur politikanët janë mbi ligjin po mbaron!",-theksoi z.Basha.

## Vetingu, Bylykbashi: Lajm i keq për politikanët mafiozë

Komisioni i Venecias i hap rrugë vetingut të politikanëve. Qëllimi i opozitës është legjitim. Parlamenti të gjejë zgjidhje nëpërmjet dialogut". Kështu e ka lexuar PD-ja opinionin përfundimtar të Komisionit të Venecias, për vetingun në politikë, ndërkohë që deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi, përfaqësues i PD në mbledhjen e Komisionit të Venecias theksoi se "Komisioni i Venecias, edhe pse një javë pasi mazhoranca rrëzoi propozimet e PD, përsëri konfirmon qëndrimin e tij se qëllimi i PD dhe opozitës shqiptare për vetingun në politikë është absolutisht legjitim". "Lajm i mirë për shqiptarët dhe i keq për politikanët mafiozë. Komisioni i Venecias i bën thirrje mazhorancës të ulet në dialog konstruktiv me opozitën për miratimin e amendamenteve kushtetuese dhe ligjit sipas udhëzimeve të Komisionit dhe shprehu gatishmërinë për të asistuar më tej në përfundimin e këtij procesi", deklaroi z.Bylykbashi. PD beson se amendimet janë nismë e Komisionit të Ligjeve, të Komisionit të Venecias, të mbështetura nga opozita. Sipas PD-së amendamentet e miratuara ndryshojnë opinionin paraprak, duke saktësuar se shtetet kanë të drejtë të kufizojnë të drejtën për t'u zgjedhur dhe amendamentet i hapin zyrtarisht rrugë vendimit të parlamentit për të miratuar vetingun në politikë".

**ERMONELA FELAJ**

Pas miratimit nga 'Venecia' të draft-opinionit për Shqipërinë, deputetja e PS-së, Ermonela Felaj tha: "shqyrtimi i nismës për vetingun në politike konfirmoi se vetingu i politikanëve duhet të ndodhë përmes institucioneve të pavarura, të dedikuara dhe në mënyrë permanente".

Basha rikthen në këshill disa nga kritikët: Jashtë Patozi, Ruli, Bregu dhe Bode

# Mblidhet sot Kuvendi i PD, kush garon për Këshillin e ri Kombëtar

## Në garë Oketa, Godo, Prenç e Biberaj



Valentina Madani

Partia Demokratike mbledh sot Kuvendin Kombëtar, i cili do të votojë për Këshillin e ri Kombëtar, që i hap rrugë strukturimit në bazë, duke zgjedhur kryesinë, sekretariatet dhe nënkryetarët. Do të jenë rreth 300 vendvotime, ku 750 delegatë do t'u drejtohen kutive për të votuar për Këshillin e ri Kombëtar. Mbledhja nis në orën 10:30 në ambientet e Pallatit të Kongreseve dhe në garë për në Këshillin Kombëtar prej 170 vendesh janë 350 kandidatë. Ky moment i hap rrugë ristrukturimit të plotë të kupolës drejtuese të Partisë Demokratike, duke nxjerrë organin që zgjedh kryesinë, nënkryetarët dhe sekretariatet. Pas mandatimit të Këshillit të ri Kombëtar, ky forum do të mblidhet për të zgjedhur organet e reja drejtuese të PD-së, kryesinë e partisë, sekretariatin dhe dy nënkryetarët e PD-së.

**RIKTHIMI**

Kreu i kësaj partie, Lulzim Basha ka vendosur të rikthejë disa figura që u larguan disa vite më parë nga PD-ja. Gazmend Oketa dhe Aleksandër Biberaj janë në garë për në Këshillin Kombëtar të PD-së. Kandidatë për Këshillin Kombëtar do të jenë të gjithë anëtarët aktualë dhe ish-deputetë, në përjashtim të Ridvan Bodes, Majlinda Bregut, Genc Rulit dhe Astrit Patozit. Basha ka deklaruar se në listë nuk janë ata ish-deputetë që janë vetëdeklaruar se nuk janë pjesë e PD-së. Në garë janë disa nga kritikët e Bashës si Tomorr Alizoti, Igli Cara, Bislim Ahmetaj, Edhit Harxhi, Edvin Kulluri, Ledina Alolli, Endira Bushati, Gent Malko, Julian Deda, Suzana Guxholli, Gent Minarolli, por edhe emra të njohur si ish-deputeti Bardhyl Londo, Selami Xhepa apo juristi i njohur Çlirim Gjata apo Rezart Prifti, Robert Budina dhe Ardian Isufi. Por në garë janë edhe drejtuesit aktualë të PD-së, përfshirë edhe krerët e departamenteve të partisë si dhe nënkryetarët e sekretari i përgjithshëm.

**AKUZA**

Mbledhjes së sotme të Kuvendit të PD-së i parapriu mbledhja e mbrëmshme e kryesisë së partisë. Arben Imami është larguar nga mbledhja, ndërsa në një proncim për mediat u shpreh se mbledhja e kuvendit nesër po bëhet në kundërshtim me rregulloren e partisë. Imami deklaroi se, "Basha tha se vendimi është marrë nga Këshilli Kombëtar". I pyetur nëse do të ketë një lëvizje brenda PD-së, ai e mohoi. Më herët Imami theksoi se kjo mbledhje vjen në një kohë kur studentët protestojnë për të drejtat e tyre, "ndërsa Basha duke vulosur përçarjen e PD - shtoi Imami - po u jep studentëve mesazhin më të gabuar nga forca politike që lindi prej të rinjve dhe rrëzoi regjimin komunist". Ai refuzon të jetë pjesë e punimeve të Kuvendit Kombëtar dhe shprehet se sot ky kuvend vulos përçarjen e Partisë Demokratike nën kryesimin e Lulzim Bashës. "Do jetë një veprim mediokër, banal dhe i shëmtuar, që do ta dëmtojë edhe më tej bashkimin e PD-së. Kur njerëzit dalin vetë në rrugë, PD s'ka zë, është memece", deklaroi z.Imami.



Ish-kryeministri Sali Berisha dhe kreu i PD-së, Lulzim Basha, në mbledhjen e fundit të Kuvendit Kombëtar

**KANDIDATËT**

Në garë janë disa nga kritikët e Bashës si Tomorr Alizoti, Igli Cara, Bislim Ahmetaj, Edhit Harxhi, Edvin Kulluri, Ledina Alolli, Endira Bushati, Gent Malko, Julian Deda, Suzana Guxholli, Gent Minarolli, por edhe emra të njohur si ish-deputeti Bardhyl Londo, Selami Xhepa apo juristi i njohur Çlirim Gjata apo Rezart Prifti, Robert Budina dhe Ardian Isufi.

**LISTA E PLOTE, KANDIDATET PER KESHILLIN KOMBETAR TE PD**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Adela Kryeziu | Artan Peqini | Endrit Kokoshi | Hysen Xhura | Mal Berisha | Rezmi Mirtaj |
| Adrian Trebicka | Artan Pogoni | Endrit Memiaj | Hysni Ahmetaj | Marash Logu | Robert Budina |
| Adriana Gjonaj | Arvit Bushati | Eneida Guria | Ibrahim Sako | Marinela Ziu | Roberto Caparota |
| Agest Kopellaj | Asllan Dogjani | Eneo Zguri | Igli Cara | Martin Biba | Roland Bejko |
| Agim Kukeli | Astrit Xake | Eni Kasmi | Ilir Dervishi | Mateo Spaho | Roland Kercuku |
| Agim Parllaku | Aulon Kalaja | Enkelejda Sallaku | Ilir Hazizolli | Matilda Qyrku | Roland Keta |
| Agron Kuliçi | Aurel Bylykbashi | Enno Bozdo | Ilir Kondi | Megi Balliu | Rrok Doda |
| Agron Musaraj | Avenir Peka | Enri Ceno | Ilir Krosi | Meri Poni | Rudi Sata |
| Agustin Kola | Avzi Ahmati | Enriketa Papa | Ina Vorfi | Merita Dekavelli | Rudin Hylviu |
| Ahmet Premci | Bardh Islamaj | Erald Kapri | Ina Zhupa | Mersi Shehu | Rudina Xhindoli |
| Ajet Ramçaj | Bardhyl Londo | Erion Gjoçi | Indrit Cara | Mimoza Hasekiu | Sahit Dollapi |
| Ajshe Isha | Bedri Mihaj | Erion Sula | Indrit Hoxha | Minushe Lazaj | Sajmir Koreshi |
| Akil Kraja | Bejdo Çela | Eris Hoxha | Indrit Vokshi | Mira Kauri | Sajmir Shatku |
| Alban Zeneli | Benardeta Syku | Eriselda Prishta | Ines Nurja | Mirela Bogdani | Selami Xhepa |
| Albert Avduli | Bernard Banushi | Erla Mehilli | Irena Progni | Mirela Karabina | Sherefedin Shehu |
| Albert Kushti | Besar Gazidede | Erlind Çomo | Irma Kopliku | Mirela Tabaku | Shkelqim Fortuzi |
| Albert Loci | Besart Kadia | Ermal Xhelilaj | Irsida Shehi | Mirgen Zaçellari | Shkelqim Krasniqi |
| Albert Melyshi | Besnik Aliaj | Ermir Gjeta | Ivi Bejtja | Monika Qosja | Shkëlqim Hoxha |
| Albina Dede | Besnik Dervishi | Ervis Xhako | Ivi Kaso | Murat Basha | Shkëlqim Hysaj |
| Aldo Myftari | Bislim Ahmetaj | Erzen Laçi | Jakup Beqiri | Myqerem Tafaj | Shpresa Breçani |
| Aleksandër Biberaj | Bledi Kasmi | Estela Gostivari | Jamarbër Malltezi | Myslym Haxhi | Silvi Bardhi |
| Aleksandër Marleci | Brikena Danaj | Etion Kapedani | Jemin Gjana | Nada Daullja | Skerdjan Dhuli |
| Alfred Ahmetcenaj | Bujar Brovina | Etleva Merko | Jola Hysaj | Nada Kallçiu | Sokol Allaraj |
| Alfred Qafa | Bujar Hoxha | Fabjan Topollaj | Jolio Dine | Namir Lapardhaja | Sokol Delia |
| Alfred Rushaj | Bujar Vukaj | Fatbardh Kadilli | Juela Hamati | Ndriçim Mehmeti | Sokol Kapidani |
| Alfrida Marku | Çelo Hoxha | Fatbardh Sallaku | Julian Deda | Ndoc Faslia | Sokol Ruka |
| Altin Çomo | Çlirim Gjata | Fatjon Bathorja | Julian Sefa | Neritan Golja | Sonila Daiu |
| Altin Meçe | Dardana Boletini | Fatmir Guda | Juvina Qevani | Nertila Qafzezi | Sorina Koti |
| Altin Ponari | Darien Xhindoli | Fatmir Merkoçi | Kasem Galla | Neshet Ngucaj | Spiro Cura |
| Alvaro Noga | Dashnor Sula | Fetah Hasanaj | Kasëm Mahmutaj | Nevila Xhindi | Spiro Vaso |
| Andi Mustafa | Denisa Daka | Fisnik Kruja | Kastriot Sulka | Niazi Kosovrasti | Stiliano Rushaj |
| Andia Pustina | Denisa Vata | Fisnik Qosja | Katerina Strati | Olgerta Shkurti | Suzana Guxholli |
| Anila Godo | Devis Osmani | Fitim Zekthi | Klea Malo | Olsi Karapici | Tasim Mema |
| Antoneta Çela | Dorian Gjokmarkaj | Flamur Gjymishka | Klodian Lata | Oriela Nebijaj | Taulant Zeneli |
| Anxhela Malko | Dorjan Teliti | Flamur Hoxha | Klodjana Shala | Osman Metalla | Taulanta Jupi |
| Arben Beqiri | Dritan Burgija | Florian Pustina | Kosta Barka | Pashk Ndoci | Teuta Starova |
| Arben Elezi | Dritan Demiraj | Gazmend Dibra | Kozma Dashi | Patrik Sadikaj | Tomorr Alizoti |
| Arben Ibroja | Dritan Haznedari | Gazmend Koduzi | Kreshnik Çipi | Paulin Marku | Tomorr Kotarja |
| Arben Muça | Dritan Shano | Gazmend Oketa | Kreshnik Çollaku | Paulin Paplekaj | Uran Derri |
| Arben Qirjako | Durim Kraja | Gazment Bardhi | Kreshnik Zgjani | Paulina Hoti | Valbona Mezini |
| Arben Ristani | Eda Grimci | Genc Radovicka | Kristi Koçibelli | Pëllumb Berisha | Valbona Mhilli |
| Arben Sefgjini | Edison Çela | Gent Malko | Laura Vorpsi | Përparim Caca | Vali Vorpsi |
| Arben Skenderi | Edith Harxhi | Gent Minarolli | Lealba Pelinku | Petraq Milo | Vasil Ndreko |
| Arber Agalliu | Edlira Late | Gentian Zëre | Lediana Fratari | Petro Vokopola | Vath Tabaku |
| Ardi Prushi | Edmond Biçoku | Gert Bogdani | Ledina Alolli | Prel Gjoni | Vendim Demaj |
| Ardian Isufi | Edmond Gjoka | Gerti Knuti | Ledina Mandia | Qamil Dika | Vesel Rizvanolli |
| Ardian Muhaj | Edmond Isaku | Gita Baltëza | Ledio Braho | Qani Xhafa | Viktor Bella |
| Ardian Muka | Edmond Palushi | Gjergji Nika | Leonard Olli | Qemal Çejku | Xheraldo Dashi |
| Ardian Turku | Edona Staka | Gjok Uldedaj | Leticia Gusho | Raina Kovaçi | Xhevdet Mehmetaj |
| Ardian Xhakoni | Eduart Kelmendi | Gjok Vuksani | Liljana Cingu | Rajmonda Bulku | Xhuljeta Kertusha |
| Ardian Zeneli | Edvin Kulluri | Gledis Çela | Liljana Elmazi | Rajmonda Marku | Ylber Vata |
| Ardit Gjinali | Elidon Nika | Gramoz Nazëraj | Lindita Protoduari | Ramiz Çoba | Ylli Kupi |
| Arian Gjini | Elmaz Haruni | Greta Deljani | Lisander Hoxha | Ramona Tullumani | Ylli Zdrava |
| Ariana Malltezi | Elvana Hana | Grigels Muçollari | Lorenc Danaj | Redi Myshketa | Zaim Kupa |
| Arlind Boshku | Elvis Malasi | Haki Mustafa | Luan Hoti | Redon Zogaj | Zamir Hoxha |
| Armand Teliti | Emiliano Mone | Halit Shamata | Luan Mustafaj | Reila Bozdo | Zamira Sina |
| Armando Merhori | Endira Bushati | Haris Vongli | Luigj Gjergji | Reldar Dedaj | Zhaneta Ndregjoni |
| Armend Gjana | Endri Jorgoni | Hasan Metuku | Luis Hoxha | Resilda Kalija | |
| Arqile Goreja | Endrin Gjipali | Hysen Kadiu | Lulzim Omuri | Rezart Prifti | |



## Kuvendi Kombëtar, Topalli akuza Bashës: Ka marrë peng partinë

Partia Demokratike do të votojë sot për Këshillin e ri Kombëtar, që i hap rrugë në një tjetër moment strukturimit në bazë, duke zgjedhur kryesinë, sekretariatet dhe nënkryetarët. Ky moment solli reagimin e kundërshtarëve të Bashës. Jozefina Topalli i përmend Bashës familjen, ndërsa shkruan se janë ata që vendosin kandidatët. Ish-kryeparlamentarja Jofezina Topalli shprehet se kreu i PD-së, Lulzim Basha, ka thyer traditën demokratike 25-vjeçare pasi nuk thirri as kryesinë, as Këshillin Kombëtar për t'u konsultuar as për mbledhjen e Kuvendit të Partisë, e cila do të zhvillohet sot. Topalli ngriti akuza ndaj familjes së Bashës duke u shprehur se gruaja, kunati, drejtoresha e bizneseve të kunatit, vjehrri dhe disa oligarkë vendosin se kush dhe ku do kandidojnë në emër të PD. "Emërimet i bën familja, lobingjet me jashtë i ndjek gruaja, ku licencat dhe ndërtimet e pallateve i mbulon vjehrri, ku në kontot bankare të kunatit, oligarkët derdhin me qindra milionë lekë, siç dëshmojnë dokumentet e publikuara në media", - shkruan Topalli.

QSHA: Kujdes, mos harroni këto dokumente ditën e testit! Rastet kur skualifikoheni

# Zbardhen datat e provimit të shtetit për mjekët dhe farmacistët

## *Ja kur duhet të kryejnë testimin stomatologët e infermierët*

Voltiza Duro

Prej javës së tretë të dhjetorit 2018 deri në fund të janarit të 2019-ës, mjekët, farmacistët, stomatologët, e infermierët do t'i nënshtrohen provimit të shtetit për profesionet e mjekësisë. Ky testim do të kryhet edhe për fizioterapistët, logopedistët, mamitë, teknikët e imazherisë dhe teknikët e laboratorit. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot kalendarin e plotë me datat e provimeve për secilin nga profesionet e sipërpërmendura. "Provimi i shtetit do të zhvillohet në godinën e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (më poshtë QSHA) me adresë: Bulevardi: "Zhan D'Ark", Nr. 23 (ish godina e ATSH), Tiranë. Kandidati duhet të paraqitet në QSHA 30 min. para fillimit të provimit të shtetit",-thekson Qendra e Shërbimeve Arsimore.

**DOKUMENTACIONI**

Në ditën e provimit kandidati duhet të ketë me vete letërnjoftimin (Kartë ID ose Pasaportë) për pjesëmarrje në provimin e shtetit (dokumenti origjinal); kopje të Kartë ID ose Pasaportë; faturën e pagesës së tarifës së provimit të shtetit për llogari të QSHA në një bankë të nivelit të dytë/ postë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në faqen zyrtare të QSHA) sipas herës së pjesëmarrjes. "Për paraqitjen në qendrat e provimit kandidati duhet të ketë parasysh rregullat e mëposhtme: ndalohet marrja me vete dhe përdorimi i celularëve dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter s'kualifikimi; ndalohet duhani, dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit; ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit",-bën me dije QSHA. Kandidatët duhet të verifikojnë emrin, atësinë, mbiemrin, si dhe datën dhe orën e provimit në faqen zyrtare të QSHA. Ligji "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë" në nenin 7 thekson se personi, që kërkon të ushtrojë një profesion të rregulluar, duhet të ketë përfunduar programin përkatës të akredituar të studimit dhe/ose kualifikime profesionale në atë profesion, të cilat vërtetohen me dokumente zyrtare, të lëshuara brenda ose jashtë vendit dhe të njohura në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

ORGANIZIMI I PROVIMEVE TË SHTETIT PËR PROFESIONET E MJEKËSISË SEZONI XV DHJETOR 2018 JANAR 2019

| E hënë 17.12.2018 | E martë 18.12.2018 | E mërkurë 19.12.2018 | E enjte 20.12.2018 | E premte 21.12.2018 |
|---|---|---|---|---|
| | | 09:00 Farmaci | 09:00 Farmaci | 09:00 Mjekësi |
| | | 11:30 Farmaci | 11:30 Farmaci | 11:30 Mjekësi |
| | | 14:00 Farmaci | 14:00 Farmaci | |
| **E hënë 24.12.2018** | **E martë 25.12.2018** | **E mërkurë 26.12.2018** | **E enjte 27.12.2018** | **E premte 28.12.2018** |
| 09:00 Mjekësi | | 09:00 Mami | 09:00 Mami | 09:00 Teknik Laboratori |
| 11:30 Mjekësi | | 11:30 Mami | 11:30 Teknik i Imazherisë | 11:30 Teknik Laboratori |
| 14:00 Mjekësi | | 14:00 Mami | 14:00 Teknik i Imazherisë | |
| **E hënë 31.12.2018** | **E martë 01.01.2019** | **E mërkurë 02.01.2019** | **E enjte 03.01.2019** | **E premte 04.01.2019** |
| | | | 09:00 Stomatologji | 09:00 Stomatologji |
| | | | 11:30 Stomatologji | 11:30 Stomatologji |
| | | | 14:00 Stomatologji | |
| **E hënë 07.01.2019** | **E martë 08.01.2019** | **E mërkurë 09.01.2019** | **E enjte 10.01.2019** | **E premte 11.01.2019** |
| 09:00 Stomatologji | 09:00 Fizioterapi | 09:00 Infermieri | 09:00 Infermieri | 09:00 Infermieri |
| 11:30 Stomatologji | 11:30 Fizioterapi | 11:30 Infermieri | 11:30 Infermieri | 11:30 Infermieri |
| 14:00 Logopedi | 14:00 Fizioterapi | 14:00 Infermieri | 14:00 Infermieri | |
| **E hënë 14.01.2019** | **E martë 15.01.2019** | **E mërkurë 16.01.2019** | **E enjte 17.01.2019** | **E premte 18.01.2019** |
| 09:00 Infermieri | 09:00 Infermieri | 09:00 Infermieri | 09:00 Infermieri | 09:00 Infermieri |
| 11:30 Infermieri | 11:30 Infermieri | 11:30 Infermieri | 11:30 Infermieri | 11:30 Infermieri |
| 14:00 Infermieri | 14:00 Infermieri | 14:00 Infermieri | 14:00 Infermieri | |
| **E hënë 21.01.2019** | **E martë 22.01.2019** | **E mërkurë 23.01.2019** | **E enjte 24.01.2019** | **E premte 25.01.2019** |
| 09:00 Infermieri | | | | |
| 11:30 Infermieri | | | | |
| 14:00 Infermieri | | | | |




## 11% e grave në moshën 20-49 vjeç, martesa kur ishin minorene

Rreth 11% e grave të moshës 20-49 vjeç, janë martuar para moshës 18 vjeç, martesa këto të përhapura kryesisht në grupet vulnerabël, në komunitetin rom dhe egjiptian, por edhe në zonat rurale. Ditën e djeshme Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me UNICEF, UNFPA, Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe me mbështetjen e Qeverisë së Suedisë, prezantuan studimin "Martesa e fëmijëve - njohuritë, qëndrimet dhe perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri". "Arma më e fortë që kemi në dorë është edukimi. Me nxitjen e arsimimit për çdo vajzë, për çdo fëmijë, do të mund të flasim nesër për më pak vajza-gra, për më pak martesa të hershme, për më pak dhunë me bazë gjinore dhe më shumë vajza që zgjedhin vetë fatin e tyre", tha Ministrja Manastirliu.


**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA KUSHTETUESE**
**KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

**SHPALLJE VENDI VAKANT**

Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit", i ndryshuar me vendimin nr.101 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 92/2017 *Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit*" s**hpall 1 (një) vend vakant për "Drejtor" në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.**

**KËRKESAT E POSAÇME TË POZICIONIT:**
a. Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Ekonomi.
b. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
c. Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

**KUSHTE TË PËRGJITHSHME:**
· Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
· Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

**Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 12 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në një nga format e dhëna më poshtë:**

· Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.
· Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: "Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Nr. 3, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 31 dhjetor 2018, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
· Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 12 dhjetor deri më 31 dhjetor 2018 në adresën info@kpa.al. KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

1. Jetëshkrim profesional në gjuhën shqipe, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
2. Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat qe janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
4. Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
5. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
6. Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
7. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

**Kandidatët të cilët aplikojnë nëpërmjet postës elektronike,** nëse do të vlerësohen që plotësojnë kriteret ligjore, duhet të paraqesin ditën e intervistës dokumentet origjinale ose të njësuara me origjinalin, që vërtetojnë kushtet e parashikuara sipas pikave 1-7.


# "Ruaj traditën, festo shqip" mbledh bashkë studiues të folklorit dhe artistë



Një grup studentësh të programit Master i Shkencave, dega Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun mblodhën në një tryezë të rrumbullakët studiues si dhe artistë në kuadër të fushatës "Ruaj traditën, festo shqip" që synon ndërgjegjësimin e të rinjve në ruajtjen e folklorit. Kjo fushatë është iniciuar mbi bazat e një detyre kursi, në lëndën Konceptim dhe Menaxhim Fushatash. Pedagogu i lëndës Ph.D. Edlira Mali është njëkohësisht edhe këshilltarja e studentëve gjatë këtij projekti, e cila i ka orientuar studentët në çdo aktivitet të tyre. Kryefjala e tryezës ishte rreziku i humbjes së trashëgimisë sonë folklorike. Studiuesit janë shprehur të shqetësuar në lidhje me vështirësinë e tejkalimit të folklorit nga brezi në brez. Duke iu referuar bartësve, gati njëzëri të gjithë ranë dakord mbi faktin se bartësit po humbasin, e ndërkohë po humbim edhe një trashëgimi kulturore. Tryeza e rrumbullakët u moderua nga gazetarja e mirënjohur Anisa Ymeri, e cila iu bashkua fushatës së studentëve për përçimin e vlerave dhe traditave folklorike shqiptare, ndërkohë që studentja Beklie Koltraka prezantoi për të pranishmit konceptin e fushatës "Ruaj traditën, festo shqip". Menaxherja e fushatës studentja Donisa Perseku falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen ndërsa përmendi arsyet e ndërmarrjes së një fushate të tillë duke u nisur edhe nga nevojat e shoqërisë sonë për të ruajtur rrënjët e tyre. Gjatë bisedës u fol edhe për vlerat e jashtëzakonshme të folklorit dhe rëndësinë e trashëgimit të saj.


**SHPALLJE ANKANDI**

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se më datë 20.12.2018 ora $8^{00}$ - $16^{00}$ ne ambjentet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i I-rë për shitjen e 4 pasurive të paluajtshme , në pronësi të Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K me vlera fillestare ne ankand: a) 252,668 (Dyqind e pesëdhjet e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e tetë) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,795 $m^2$, rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/66, Vol.18, Fq.152, ZK.2704 b) 244,532 (Dyqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e tridhjet e dy) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,705 $m^2$, rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/67, Vol.18, Fq.153, ZK.2704 c) 316,400 (Treqind e gjashtëmbëdhjete mije e katërqind) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 3,500 $m^2$, rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/72, Vol.19, Fq.146, ZK.2704 c) 135,600 (Njëqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 1,500 $m^2$, rregjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/73, Vol.19, Fq.147, ZK.2704.
**Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

Kreu i Drejtorisë së Transportit Rrugor: Përgjegjësia, e kompanisë private

# Durrës, maskat grabisin me armë 7.5 mln lekë të Drejtorisë së Patentave

## Tre autorët sulmuan makinën e blinduar, që transportonte paratë në një bankë e nivelit të dytë

Klodiana Haxhiaj

DURRËS

Një grabitje me armë zjarri ka ndodhur dje në Durrës. Tre persona të maskuar dhe të armatosur me automatikë i kanë zënë pritë një makine të blinduar, e cila po transportonte paratë e Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor. Mësohet se nën kërcënimin e armëve, agresorët kanë arritur të marrin kasafortën me 7.5 milionë lekë të reja. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Durrësit bënë me dije se ngjarja ka ndodhur pasditen e djeshme në Shkozet. Pasi kanë marrë paratë, grabitësit janë larguar me shpejtësi në drejtim të Shijakut. Ndërkaq, uniformat blu kanë nisur kontrollet në të gjithë zonën, por nuk kanë mundur të venë në pranga autorët e krimit. "Sot rreth orës 16:50, në lagjen nr.14 Shkozet, dyshohet se 3 persona me një mjet, nën kërcënimin e armës dhe të maskuar i kanë dalë përpara një mjeti (shoqëri private sigurimi) që po transportonte lekët e Ndërmarrjes së Drejtorisë Rajonale të Transportit Durrës në një bankë të nivelit të dytë i kanë marrë një shumë parash. Efektivët e policisë po punojnë për kapjen e autorëve të dyshuar dhe zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes", thuhej në njoftimin zyrtar të policisë së Durrësit. Ndërkohë, në lidhje me ngjarjen ka reaguar kreu i Drejtorisë së Transportit Rrugor në Durrës, Roni Shqopa. Ai konfirmoi për "Gazeta Shqiptare" se personat e maskuar kanë vjedhur shumën prej 7.5 milionë lekësh të reja dhe se përgjegjëse është kompania transportuese e parave.

**HETIMET**

Grabitja ka ndodhur në zonën e Shkozetit, 100 m para mbikalimit të Unazës së plazhit. Tre personat e maskuar kanë shfrytëzuar kohën e keqe me shi dhe në një moment kur nuk ka pasur qarkullim rrugor të dendur dhe i kanë zënë pritë makinës së blinduar së një firme private sigurimi që po transportonte paratë e Drejtorisë Rajonale të Transportit Durrës në një bankë të nivelit të dytë. Burime pranë grupit hetimor pohuan për "GSH" se autorët e krimit kanë qenë në dije të transportit të parave si dhe shumës që po transportohej në një gjatësi rruge prej 500 m. Kaq është distanca mes Drejtorisë së Patentave dhe bankës së nivelit të dytë ku do të depozitoheshin paratë. Po të njëjtat burime (referuar informacioneve të dhëna dhe nga dëshmitarët) sqaruan se grabitësit fillimisht kanë neutralizuar policët private dhe nën kërcënimin e armëve i kanë urdhëruar të hapnin derën e blindit. Ata kanë marrë kasafortën dhe janë larguar me një automjet tip "Benz" me ngjyrë të zezë në drejtim të Shijakut. Maskat kanë përfituar dhe nga shiu i dendur dhe errësira, për t'i shpëtuar ndjekjes së policisë. Sipas hetuesve të çështjes, gjithçka ka ndodhur shumë shpejt dhe ka qenë e mirorganizuar. Pas sinjalizimit për ngjarjen, policia ka ushtruar kontrolle të shumta në të gjithë zonën dhe përgjatë brigjeve të lumit Erzen deri në orët e vona të mbrëmjes. Mësohet se blutë kanë rënë në gjurmë të grabitësve dhe po punon për kapjen e tyre.

**KREU I DREJTORISË SË PATENTAVE**

"7.5 milionë lekë është shuma e grabitur. Bëhet fjalë për të gjitha arkëtimet e mbledhura gjatë javës. Paratë po transportoheshin nga institucioni që drejtoj unë në një bankë të nivelit të dytë. Ne kemi një kontratë me kompaninë e transportit të parave dhe në rastin konkret, përgjegjësia është e kësaj kompanie që ka marrë përsipër shërbimin. Ne si drejtori kemi dorëzuar paratë, ndërkohë që edhe banka nuk ka përgjegjësi për atë që ndodhi", tha kreu i Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor në Durrës, Roni Shqopa. Sipas tij, kjo është hera e parë që grabiten paratë e drejtorisë në fjalë. Nga ana tjetër, mësohet se në Shkozet gjendet një numër i konsiderueshëm i bankave të nivelit të dytë dhe pika të shkëmbimit valutor dhe se në këtë zonë kanë ndodhur grabitje të njëpasnjëshme ndër vite të shumave të konsiderueshme të parave.


Vendi ku ndodhi grabitja


Kreu i Drejtorisë së Transportit Rrugor në Durrës, Roni Shqopa

**GRABITJA**

Burime pranë grupit hetimor pohuan për "GSH" se autorët e krimit kanë qenë në dije të transportit të parave si dhe shumës që po transportohej në një gjatësi rruge prej 500 m. Kaq është distanca mes Drejtorisë së Patentave dhe bankës së nivelit të dytë ku do të depozitoheshin paratë. Po të njëjtat burime sqaruan se grabitësit fillimisht kanë neutralizuar policët privatë dhe nën kërcënimin e armëve i kanë urdhëruar të hapnin derën e blindit. Ata kanë marrë kasafortën dhe janë larguar me një automjet tip "Benz" me ngjyrë të zezë në drejtim të Shijakut.

## SHKURT

### "Vol-Vo 4", arrestohet 32-vjeçari i shpallur në kërkim

**LEZHË** - Policia e Lezhës ka arrestuar një 32-vjeçar, i cili ishte shpallur në kërkim. Bëhet fjalë për shtetasin Emanuel Gjura, banues në Lezhë, ndaj të cilit Gjykata e Shkallës Parë për Krimet e Rënda ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg". Kjo për veprat penale "Shpërdorim detyre", "Grup i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga organizata dhe grupi i strukturuar kriminal", "Falsifikim i dokumenteve", "Falsifikim i vulave, stampave dhe i formularëve" dhe "Shpërdorim i tokës". 32-vjeçari dyshohet të jetë i implikuar në grupin e strukturuar kriminal në fushën e krimit ekonomik, të goditur në operacionin "Vol-Vo 4", në tetor të këtij viti.

### Shpërndanin heroinë, përfundojnë në pranga dy të rinj

**KORÇË** - Dy persona kanë rënë në prangat e policisë, pasi u kapën duke shpërndarë droga të forta. Burime zyrtare nga policia e Korçës bënë me dije se shtetasit M. Xh., 34 vjeç dhe L.M., 36 vjeç, të dy të dënuar më parë për vjedhje, iu bllokuan 423.8 gr heroinë. Po ashtu, atyre iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale një sasi kanabis, 19 tableta metadoni, si edhe fishekë luftarakë. Veprimet procedurale të rastit u kryhen nga specialistët e Seksionit për Narkotikët, të cilët referuan materialet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë.



## Prishi 4 objekte, dënohet me burg inspektori i IKMT, Fatmir Metaj

**TIRANË** - Gjykata e Tiranës ka dënuar me 1 vit burg inspektorin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Fatmir Metaj. Gjithashtu, Metaj është dënuar me 3 vite pezullim detyre, pasi akuzohet për "shpërdorim detyre". Sipas prokurorisë, Fatmir Metaj u mor i pandehur për prishjen e katër objekteve, një prej tyre me leje ndërtimi dhe tri objekte në proces legalizimi në Tiranë dhe Vaqarr. Po sipas organit të akuzës, objektet e prishura në kundërshtim me ligjin janë realizuar përgjatë viteve 2013-2014 dhe kanë qenë të ndërtuara në rrugën "Mihal Grameno" dhe përgjatë rrugës së Vaqarrit. Fatmir Metaj, ishkreu i komisariatit të Tropojës në vitin 1998, është një emër i lakuar edhe në vrasjen e deputetit demokrat Azem Hajdari, pasi automjeti me të cilin udhëtoi Famir Haklaj nga Tropoja drejt Tiranës ishte në pronësi të tij (Metës).

## Tritol banesës së gruas së biznesmenit të vrarë para tri vitesh, Hyqmet Nexhipit

**VLORË** - Tronditet Vlora. Një shpërthim me eksploziv është shënuar mbrëmë në një banesë në lagjen "Çole" të këtij qyteti. Mësohet se shpërthimi ka ndodhur në katin e dytë të një apartamenti të marrë me qira nga Teuta Prifti, gruaja e biznesmenit Hyqmet Nexhipi, i cili u ekzekutua në janar të vitit 2016 në rrugën Transballkanike. Burime nga policia lokale bënë me dije se si pasojë e shpërthimit të tritolit që ishte vendosur jashtë derës së apartamentit janë shkaktuar vetëm dëme materiale. Blutë kanë shkuar shpejt në vendngjarje dhe kanë nisur hetimet për identifikimin dhe kapjen e autorit/ve. Më 23 janar të vitit 2016, Hyqmet Nexhipi u gjet i vrarë në makinën e tij tip "Honda" në rrugën "Transballkanike". Ndërsa, makina e autorëve u gjet në lagjen "Çole" e braktisur. 53-vjeçari ishte pronar i anijes së peshkimit "Drita" dhe rezultonte i dënuar para 6 vitesh në Itali për shfrytëzim prostitucioni.


Biznesmeni i vrarë, Hyqmet Nexhipi



## Lista e plotë me emrat e përfituesve, të cilët marrin këstin e tretë të dëmshpërblimit

# Ish-të përndjekurit, 2771 trashëgimtarët që marrin paratë

## *Ministria: Dokumentet që duhet të plotësoni*

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë që nuk kanë marrë dëmshpërblimi e këstit të tretë duhet të dorëzojnë sa më parë në Ministrinë e Financave dokumentet që iu mungojnë në dosje për të mos humbur të drejtën për të marrë paratë. Burime zyrtare nga Ministria e Financave bëjnë të ditur se janë mbi 2771 trashëgimtarë të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist, të cilët duhet të plotësojnë dosjet për të filluar pagesat e këstit të tretë. Sipas të njëjtave burime mësohet se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listën e përfituesve.

**DOKUMENTET**

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, emër/mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një germë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykate që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave.




### EMRAT ME PERFITUESIT NGA TRASHEGIMTARET E TE PERNDJEKURVE

| NR. DOSJES | EMER | ATESIA | MBIEMER |
|---|---|---|---|
| 5325 | | NDUE | |
| | MARIJE | ZEF | MARGJINI |
| | LUAN | GJETE | MARGJINI |
| | ARBEN | GJETE | MARGJINI |
| | ALBAN | GJETE | MARGJINI |
| | ELIONA | GJETE | MARGJINI |
| 18938 | | MUHARREM | |
| | LIRI | RIZA | DHEMBI |
| | STAVRO | FEJZULLA | DHEMBI |
| | TAHIR | FEJZULLA | DHEMBI |
| | NAZO | FEJZULLA | DHEMBI |
| | NEVRUS | FEJZULLA | DHEMBI |
| 21526 | | GALIP | |
| | NEVIN | YZEDIN | GODO (VRIONI) |
| 19528 | | NIKOLL | |
| | ZEF | NIKOLL | PRENGA |
| | LLESH | NIKOLL | PRENGA |
| 3019 | | MYSLYM | |
| | KRENAR | HAKI | VREKAJ |
| 4885 | | | |
| | DIJE | AHMET | MANSAKU |
| | IKBALE | MASAR | GJYZELI |
| | XHELAL | MASAR | MANSAKU |
| | BESNIK | MASAR | MANSAKU |
| | QEMAL | MASAR | MANSAKU |
| | DRITA | MASAR | CYRBJA |
| 974 | | | |
| | AGE | GJOKE | ELEZI |
| | LUCIJE | PREKE | MAZIA |
| | VERONIKE | PREKE | MARKU |
| | RAKE | PREKE | GJELOSHI |
| | MIR | PREKE | ELEZI |
| | TONIN | PREKE | ELEZI |
| 4120 | | | |
| | ANTONETA | PASHKO | LULAJ |
| | MANUEL | PASHKO | SHABI |
| | NIK | PASHKO | SHABI |
| | | | |
| | PRELE | VATE | LULAJ |
| 1676 | | | |
| | ZAHIDE | VESEL | HAREMI |
| | ZELIHA | MUHAMET | ULAJ |
| | MUSTAFA | MUHAMET | HAREMI |
| | MUSA | MUHAMET | HAREMI |
| | MIRSIJE | MUHAMET | DORZI |
| | MIRANDA | MUHAMET | HAREMI |
| 2004 | | | |
| | XHEMILE | RUZHDI | RAMA |
| 3432 | | | |
| | LUMIJE | HALIM | CEKICI |
| | KUMRIE | HASAN | LOCA |
| | XHILKE | HASAN | SUFA |
| | AJSHE | HASAN | LOCA |
| | SHEZIVAR | HASAN | CEKICI |
| | HAJRIE | HASAN | GJANA |
| 2073 | | | |
| | LULE | NOSH | GURRAJ |
| | LENE | PREL | PECAJ |
| | GJERGJ | PREL | GURRAJ |
| | DODE | PREL | GURRAJ |
| | SHAQE | PREL | VUCKAJ |
| | GJYSTE | PREL | MALAJ |
| | MRI | PREL | NOCI |
| | LULE | PREL | PRELASHI |
| | ANGJELINA | PREL | TAVANAJ |
| 3030 | | | |
| | SULLTANE | ADEM | MARKU |
| | ALI | LAM | MARKU |
| | GANI | LAM | MARKU |
| | VESEL | LAM | MARKU |
| | KADE | LAM | METRA |
| | BUKURIJE | LAM | NDREU |
| 1892 | | | |
| | MINE | MAHMUT | KURPALI |
| | LULZIM | DAUT | KURPALI |
| | FLAMUR | DAUT | KURPALI |
| | LULJETA | DAUT | KURPALI |
| | DRITAN | DAUT | KURPALI |
| | AGIM | DAUT | SELIMI |
| | HANIFE | DAUT | KURPALI |
| | | | |
| 336 | | | |
| | HAJDAR | AHMET | LLESHANAKU |
| | SELMAN | AHMET | LLESHANAKU |
| | BURBUQE | AHMET | MOLI |
| | FERIT | AHMET | LESHANAKU |
| 1276 | | | |
| | SALI | RAMAZAN | GURI |
| | BARDHYL | RAMAZAN | GURI |
| | ARTAN | RAMAZAN | GURI |
| | ARTUR | RAMAZAN | GURI |
| | ALBAN | RAMAZAN | GURI |
| | FATOS | RAMAZAN | GURI |
| 4229 | | | |
| | AREZA | GAFUR | CICI |
| | SAMI | REXHEP | CICI |
| | MEXHIT | REXHEP | CICI |
| | AZBIJE | REXHEP | GJANA |
| | HUME | REXHEP | SHIMA |
| | SABRIJE | REXHEP | SPAHO |
| | SHEMSHI | REXHEP | CICI |
| 174 | | | |
| | HATIXHE | ZYBER | SIJAMI |
| | ABDURRA | REXHEP | SIJAMI |
| | QEUTHERE | REXHEP | VRIONI |
| | VJOLLCA | REXHEP | DEDJA |
| | NAZIRE | REXHEP | DUKA |
| | RAMAZAN | REXHEP | SIJAMI |
| 294 | | | |
| | SABO | MURAT | HADERI |
| | HYSNI | RAKIP | HADERI |
| | ARDIAN | RAKIP | HADERI |
| | TASULA | RAKIP | DHIMITRI |
| 1410 | | | |
| | LIDA | NAZMI | AJCE |
| 759 | | | |
| | RUZHDI | XHELAL | PRROJ |
| 773 | | | |
| | EMINE | | GAZIDEDE |
| | NJAZI | EMRULLA | GAZIDEDE |
| | XHEVDET | EMRULLA | GAZIDEDE |
| 3306 | | | |
| | SADRIJE | SEHIT | DVORANI |
| | ENGJELL | FETI | DVORANI |
| | MAKSIM | FETI | DVORANI |
| 2370 | | | |
| | DIN | ALUSH | KOLECI |
| | ZADE | ALUSH | PREVANA |
| | BEDRI | ALUSH | KOLECI |
| | AGRON | ALUSH | KOLECI |
| | AVNI | ALUSH | KOLECI |
| | LIHE | ALUSH | NEZAJ |
| | AGIM | ALUSH | KOLECI |
| 4471 | | | |
| | NAZIME | RAKIP | ZOTOLLI |
| | RIZA | QAMIL | ZOTOLLI |
| | SERIJE | QAMIL | HAJDERLLIU |
| 935 | | | |
| | SELMAN | KAMBER | DAIJA |
| | BALLE | KAMBER | DAIJA |
| | AISHE | KAMBER | DAIJA |
| | MUSTAF | KAMBER | DAIJA |
| | JAKUP | KAMBER | DAIJA |
| 12380 | | | |
| | MARIE | | RUSHAJ |
| | MAGDALENA | SIMON | RUSHAJ |
| | ALFONS | SIMON | RUSHAJ |
| | LORETA | SIMON | RUSHAJ |
| | ROZETA | SIMON | RUSHAJ |
| 12193 | | | |
| | FARUSHE | BEQO | CERRIKU |
| | NAZMI | JAKUP | CERRIKU |
| | HAKI | JAKUP | CERRIKU |
| | BAFTI | JAKUP | CERRIKU |
| 11041 | | | |
| | MATILDE | KOLE | DEDA |
| | ANTONELA | ZEF | LULI |
| 12685 | | | |
| | FITNET | | GOJANI |
| | ALKET | | GOJANI |
| 16136 | | | |
| | ZENGJINE | ISMAIL | ZAIMI |
| | ZIJA | FERIT | ZAIMI |
| | ERVEHE | FERIT | ZAIMI |
| 15310 | | | |
| | FLORA | MUSTAFA | KALOSHI |
| | MUNIR | SHAQIR | KALOSHI |
| | TOMOR | SHAQIR | KALOSHI |
| 10858 | | | |
| | EFTALI | VASIL | GJINI |
| | AURELA | ANDREA | FORA |
| | ENDOKLIA | ANDREA | BINJAKU |
| | IRENA | ANDREA | BITRI |
| 12068 | | | |
| | FILE | GJOK | KOKAJ |
| | MRI | LUC | DEDVUKAJ |
| 13982 | | | |
| | HASAN | SALI | MARTINAJ |
| | KADE | SALI | KORRA |
| | LINDITA | HAMIT | MARTINAJ |
| 15271 | | | |
| | SEHAVET | MUHAREM | KELLEZI |
| | MASKIM | ABDYL | KELLEZI |
| | LEON | ABDYL | KELLEZI |
| | YLLI | ABDYL | KELLEZI |
| 11567 | | | |
| | NURFEJA | MUHAMET | KOPRENCA |
| | XHELAL | SAMI | KOPRENCA |
| | LILI | SAMI | KRESHPA |
| 11728 | | | |
| | MEFA | REFAT | MIRAKA |
| | BUKURI | REFAT | VISHKULLI |
| | GJYLE | REFAT | VISHKULLI |
| | NAZMI | REFAT | VISHKULLI |
| | AQIF | REFAT | VISHKULLI |
| 14735 | | | |
| | NIKOLL | NDUE | NIKOLLI |
| | NDREC | NDUE | NIKOLLI |
| | DAVE | NDUE | THEKNA |
| | PJETER | NDUE | NIKOLLI |
| | MARTE | NDUE | MARKU |
| | TONIN | NDUE | NIKOLLI |
| | GJELINA | NDUE | NDOJ |
| 12472 | | | |
| 13208 | | | |
| | ANILA | EMEROR | CEKIRI |
| | SKENDER | EMEROR | KALECI |
| 15781 | | | |
| | BASHKIM | ADEM | MALAJ |
| | BILAL | ADEM | MALAJ |
| | FLAMUR | ADEM | MALAJ |
| | HYRI | ADEM | MALAJ |
| | NIMETE | ADEM | SELIMI |
| | SHPETIM | ADEM | MALAJ |
| | VOJSAVA | ADEM | BAKAJ |
| 14006 | | | |
| | SEKINE | HAMZA | PETI |
| | MAXHID | HAMZA | CUNGU |
| | AMIR | HAMZA | CUNGU |
| 10906 | | | |
| | XHEVAIRE | XHEMALI | KANINA |
| | FATBARDHA | MINTAS | CENOLLI |
| | SHPRESA | MINTAS | CAMI |
| 12341 | | | |
| | DYLBERE | MUHARREM | SULAJ |
| | GJYLE | MUHARREM | LLESHI |
| | RUZHDIJE | MUHARREM | HAKA |
| | XHAVIT | MUHARREM | KAMBERI |
| | SHABAN | MUHARREM | KAMBERI |
| 11145 | | | |
| | REMZI | RIZA | KUCI |
| | | | |
| 15460 | | | |
| | HAZBIE | TAHIR | HIDRI |
| | SULEJMAN | HALIL | HIDRI |
| | BARJAM | HALIL | HIDRI |
| | NAZMIE | HALIL | HIDRI |
| 15285 | | | |
| | NURIJE | HAMO | MUJAJ |
| | XHAFER | ADEM | MUJAJ |
| | ARBEN | ADEM | MUJAJ |
| | ENVER | ADEM | MUJAJ |
| | SKENDER | ADEM | MUJAJ |
| | MYZAFERE | ADEM | MUJAJ |
| 12652 | | | |
| | ENVER | HALIL | NEZIRI |
| | LINDITA | HALIL | MULLETI |
| | ARBEN | HALIL | NEZIRI |
| | MERITA | HALIL | NEZIRI |
| | ALKJONT | HALIL | NEZIRI |
| | AMERILDA | HALIL | NEZIRI |
| 15390 | | | |
| | PARASHQEVI | VANGJEL | FILI |
| | JORGO | JANI | FILI |
| | FOTINO | JANI | ZINGO |
| | NIKOLLA | JANI | FILI |
| | SOTIR | JANI | FILI |
| | ANSTASIA | JANI | CAKO |
| | SPIRO | JANI | FILI |
| | ARHILEA | JANI | FILI |
| | GRIGOR | JANI | FILI |
| | DHIMITRULLA | JANI | XHOMAKA |
| | VANGJEL | JANI | FILI |
| 8800 | | QAZIM | |
| | ZARIFE | ABIDIN | VESHO |
| | AVNI | BEKTASH | VESHO |
| | BEXHET | BEKTASH | VESHO |
| | | | |
| | FEIM | BEKTASH | VESHO |
| | FERIT | BEKTASH | VESHO |
| | FUAT | BEKTASH | VESHO |
| 7395 | | | |
| | GJELA | GJIN | GJINI |
| | GJOK | GJIN | GJINI |
| | MARA | NDUE | GJINI |
| | NIKOLL | GJIN | GJINI |
| | PRENA(nusha | GJIN | GJINI |
| | NIKOLLA | BEKTASH | VESHO |
| 7918 | | NDUE | |
| | ANTONIO | GJON | CEFA |
| 7076 | | ISUF | |
| | HIQMET | HYSNI | POLLO |
| | XHEMALI | HYSNI | POLLO |
| | FITIM | HYSNI | POLLO |
| | ZAJDE | HYSNI | PECA(POLLO) |
| | | | |
| 10634 | | AVNI | |
| | AFERDITA | YMER | MURATAJ |
| | | | |
| 7103 | | SPIRO | |
| | NAPOLEON | SOFOKLI | PERI |
| | SOFI | SOFOKLI | MINGA |
| 7614 | | GLIGOR | |
| | SOFIE | MICO | GJYZELI |
| | ANTHI | ILIA | CARA |
| | ELEFTERIA | ILIA | KALO |
| | LLAMBI | ILIA | |
| | NIQI | ILIA | GOXHA |
| | STOMATO | ILIA | KUMBULLI |
| | ARTA | ILIA | PAPAJANI |
| | VASILIKA | ILIA | LACKA |
| | VASIL | ILIA | GJYZELI |
| 8484 | | PARIANI | |
| | OLLGA | SPIRO | LLOLI |
| | VASILIKA | VAJO | GALACI |
| 8062 | | SALIM | |
| | EDLIRA | ILMI | SHARRA |
| | RAJMOND | ILMI | XHAFERRAJ |
| 12345 | | MUSTAFA | |
| | REKO | MEHDI | SELFO |
| | LIRIM | MEHDI | SELFO |
| | SHPETIM | MEHDI | SELFO |
| | | | |
| 7176 | | HAXHI | |
| | ASTRIT | ZENEL | SINANAJ |
| 10771 | | PETRO | |
| | IRINA | ALEKS | KARABLIN |
| | PETRO | ALEKS | KARABLIN |
| | | | |
| 14572 | | HALIL | |
| | HALIL | SYLEJMAN | HOXHAJ |
| | LEJETA | SYLEJMAN | HOXHAJ |
| | NAJADA | SYLEJMAN | HOXHAJ |
| | NEVILA | SYLEJMAN | HOXHAJ |
| | NURIJE | SYLEJMAN | HOXHAJ |
| | | | |
| 14764 | | LUSH | |
| | EJELUSH | JAK | KODHELI |
| | AGATA | JAK | NOCKS |
| 9525 | | ISTREF | |
| | ADMIR | SHABAN | PONARI |
| | ALI | SHABAN | PONARI |
| | BASHKIM | SHABAN | PONARI |
| | BEDRIE | SHABAN | PONARI |
| | HAJRIE | SHABAN | KUCANA |
| | MRI | KOLE | PONARI |
| 14571 | | HAXHI | |
| | HAXHI | RUSTEM | SHARRA |
| | NURIJE | RUSTEM | HOXHA |
| | REMZI | RUSTEM | SHARRA |
| | XHAVIT | RUSTEM | SHARRA |
| 8317 | | MERSIN | |
| | LUTFIJE | ALUSH | HOXHAJ |
| | BASHKIME | MALO | KUCI |
| | HAMZO | MALO | HOXHAJ |
| | ELMAS | MALO | HOXHAJ |
| | AFERDITA | MALO | ARIZAJ |
| | SOFIE | MALO | VRESHTAZI |
| | ZARIFE | MALO | RAMAJ |
| | LEJLI | MALO | FIKAJ |
| 10959 | | JANCE | |
| | EDUARD | XHEVIT | ZALOSHNJA |
| | MERITA | XHEVIT | ZALOSHNJA |
| | | | |
| 10360 | | VEXHI | |
| | AZIZ | RAMADAN | KURTI |
| | BEQIR | RAMADAN | KURTI |
| | JONUZ | RAMADAN | KURTI |
| | KADIE | RAMADAN | NEZHA |
| | LUTFIE | RAMADAN | DODA |
| | SHAME | RAMADAN | KURTI |
| | RAMAZAN | RAMADAN | KURTI |
| | | | |
| 11143 | | RAMADAN | |
| | AGIM | BEHAR | POLOVINA |
| | ASTRIT | BEHAR | POLOVINA |
| | VIZHDAN | BEHAR | KACANI |
| | DRITA | BEHAR | ZALOSHNJA |
| | DALLENDYSHE | BEHAR | MEZINI |
| 10300 | | BAJRAM | |
| | ESMA | SALI | PLAKALLIU |
| | LAVDIJE | SALI | LICI |
| | NUREDIN | SALI | MEMA |
| | SHAZINE | SALI | XHARO |
| | XHEVAHIR | SALI | MEMA |

Qeveria miraton vendimin për kompensimin financiar të atyre që u janë zënë tokat nga "informalët"

# Emrat e pronarëve, si ndahen 6 milionë euro

## *ALUIZNI publikon listën e përfituesve në Tiranë, Elbasan, Vlorë, etj*

Këshilli i Ministrave ka miratuar pardje vendimin për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet informale në drejtoritë e ALUIZNI-t: Tiranë Veri, Elbasan, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Vlorë, Durrës, Tiranë Rurale, Sarandë, Shkodër, Lezhë, Fshatra Turistikë dhe Kamzë Vorë. Dje, ALUIZNI bëri publik emrat e përfituesve.

Masa e kompensimit është 59 975,25 m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 801 927 925,69 lekë. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet pa leje shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, pas miratimit nga kreditori. Gjithashtu, për një sërë parcelash, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronave, pas zgjidhjes në rrugë gjyqësore të shkakut të kufizimit.

### AGJENCIA E LEGALIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE/NDERTIMEVE INFORMALE
### LISTA EMERORE E SUBJEKTEVE QE PREKEN NGA NDERTIMET INFORMALE TE KUALIFIKUARA, MASA DHE VLERA E SHPERBLIMIT

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 433 | EMINE | HAZIS | MURATI | | | |
| | | | 434 | GJYLE | RIZA | ELEZI | | | |
| | | | 435 | IKE | ALI | BEQIRI | | | |
| | | | 436 | TUSHE | ALI | NIPOLLI | | | |
| | | | 437 | SKENDER | ALI | ELEZI | | | |
| | | | 438 | FLUTUR | ALI | ALLA | | | |
| | | | 439 | DALLANDYSHE | | KISHTA | | | |
| | | | 440 | HUME | ALI | SHABANLLARI | | | |
| | | | 441 | HYRI | KOCI | ELEZI | | | |
| | | | 442 | ZYRA | HAXHI | RAGA | | | |
| | | | 443 | HURMA | HAXHI | URUÇI | | | |
| | | | 444 | SADIK | HAXHI | ELEZI | | | |
| | | | 445 | RAMAZAN | HAXHI | ELEZI | | | |
| | | | 446 | RRUZHDIJE | HAXHI | KOÇIU | | | |
| | | | 447 | BANUSH | RIZA | NASKJA | | | |
| | | | 448 | MANUSHAQE | RIZA | SENJA | | | |
| | | | 449 | ALUSH | | DERVISHI | | | |
| | | | 450 | PELLUMB | | DERVISHI | | | |
| | | | 451 | LEONIDHA | ALUSH | DERVISHI | | | |
| | | | 452 | TAULAND | ALUSH | DERVISHI | | | |
| QAMIL | MUSTAFA | GJOSHI | 453 | GJERGJI | SALUSH | DERVISHI | 226.50 | 234 | 53,001.00 |
| QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN , ZONA KADASTRALE 1742 | | | | | | | | | |
| SOKOL | KOLE | TOPI | 454 | PETRO | ANASTAS | TOPI | 252.00 | 248 | 62,496.00 |
| QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN , ZONA KADASTRALE 8522 | | | | | | | | | |
| HALIT | SALI | GARUNJA | 455 | NIGJARE | | SHQERRA | | | |
| MEREME | XHEMAL | SEFERI | 456 | ANETA | | SHQERRA | | | |
| | | | 457 | XHULJANA | | SHQERRA | | | |
| | | | 458 | FATBARDHA | | SHQERRA | | | |
| | | | 459 | ELUERT | | SHQERRA | | | |
| | | | 460 | ROVENA | | SHQERRA | | | |
| | | | 461 | XHANI | | SHQERRA | | | |
| | | | 462 | BEATRIÇE | | SHIJAKU | | | |
| | | | 463 | MUHAZEZ | | SHIJAKU | | | |
| | | | 464 | ALBERT | | SHIJAKU | | | |
| | | | 465 | LUMTURI | | SHIJAKU | 56.20 | 12,764 | 717,336.80 |

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 466 | BLERTA | | SHIJAKU | | | |
| | | | 467 | ABDYL | | SHIJAKU | | | |
| | | | 468 | SHKENDI | | DERVISHI | | | |
| | | | 469 | SHKELQIM | | DERVISHI | | | |
| | | | 470 | PAJTIM | | DERVISHI | | | |
| | | | 471 | EDMOND | | DERVISHI | | | |
| | | | 472 | ILIR | | DERVISHI | | | |
| MAHMUT | ÇERÇIZ | SHABANI | 473 | SHPRESA | | QAFLESHI | 24.20 | 12,764 | 308,888.80 |
| | | | 474 | YMER | SULEJMAN | TABAKU | | | |
| | | | 475 | FATIME | SULEJMAN | TABAKU | | | |
| | | | 476 | HYSNIJE | SULEJMAN | TABAKU | | | |
| | | | 477 | HAMALIJE | SULEJMAN | TABAKU | | | |
| | | | 478 | BARDHYLE | MUHARREM | TABAKU | | | |
| | | | 479 | NEXHMIJE | MUHARREM | TABAKU | | | |
| HASAN | JONUZ | PEPA | 480 | EMINE | MUHARREM | TABAKU | | | |
| | | | 481 | GEZIM | MUHARREM | TABAKU | | | |
| | | | 482 | HAMIDE | HASAN | TABAKU | | | |
| | | | 483 | BURHAN | HASAN | TABAKU | | | |
| | | | 484 | NEXHAT | HASAN | TABAKU | | | |
| | | | 485 | MIRANDA | RRAPUSH | TABAKU | | | |
| | | | 486 | SULEJMAN | IBRAHIM | TABAKU | | | |
| | | | 487 | MARSEL | IBRAHIM | TABAKU | 269.2 | 12,764 | 3,436,068.80 |
| QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN , ZONA KADASTRALE 8524 | | | | | | | | | |
| PETRIT | MUSA | SHARRA | 488 | SOFIJE | | BINJAKU | | | |
| KELMEND | PETRIT | SHARRA | 489 | SUZANA | | BINJAKU | | | |
| | | | 490 | AFERDITA | | NDREU | | | |
| | | | 491 | BUKURIJE | | NIKOLLA | | | |
| | | | 492 | VJOLLCA | | ZAMA | | | |
| | | | 493 | VERONIKA | | HAXHIYMERI | | | |
| | | | 494 | NIKOLLAQ | | BINJAKU | 87.60 | 13,854 | 1,213,610.40 |
| | | | 495 | SOTIRAQ | SPIRO | BINJAKU | 8.90 | 13,854 | 123,300.60 |
| QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN , ZONA KADASTRALE 8525 | | | | | | | | | |
| | | | 496 | EMINE | MUSA | BELEGU | | | |
| | | | 497 | BEXHET | MUSA | BELEGU | | | |

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit (m²) | Çmimi (leke/m²) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 498 | SUZANA | ESAT | SORRA | | | |
| | | | 499 | IKBAL | IBRAHIM | SORRA | | | |
| | | | 500 | ADELAJDA | EDMOND | SORRA | | | |
| | | | 501 | OGERTA | EDMOND | SORRA | | | |
| | | | 502 | DESART | EDMOND | SORRA | | | |
| | | | 503 | ELISABETA | ESAT | SORRA | | | |
| | | | 504 | ELIDA | ESAT | SORRA | | | |
| | | | 505 | LUAN | XHAFERR | BELEGU | | | |
| | | | 506 | MARLENA | XHAFERR | BELEGU | | | |
| | | | 507 | BEHIJE | HAJDAR | BELEGU | | | |
| | | | 508 | FATMIRA | HAJDAR | BELEGU | | | |
| | | | 509 | FLUTUR | HAJDAR | BELEGU | | | |
| XHEVAHIR | REXHEP | FILJA | 510 | ERJETA | HAJDAR | BELEGU | 297.20 | 14,192 | 4,217,862.40 |
| SHPETIM | PAVLI | KARAJ | 511 | ARBEN | SAMI | DOKO | | | |
| PRANVERA | KOL | KARAJ | 512 | BULENT | TEKI | TELA | | | |
| | | | 513 | EDMOND | TEKI | TELA | | | |
| | | | 514 | FATBARDH | SAMI | DOKO | | | |
| | | | 515 | FELATUN | MAZLLEM | KARAISKAJ | | | |
| | | | 516 | GJERAK | MAZLLEM | KARAISKAJ | | | |
| | | | 517 | HAJALI | ISMAIL | YPI | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 518 | LAVDIJE | SKENDER | KALASA | | | |
| | | | 519 | SHAZIVAR | MASAR | KARAOSMANI | | | |
| | | | 520 | SHEGUSH | MASAR | KOSOVA | | | |
| | | | 521 | NASFIJE | TEKI | SELENICA | | | |
| | | | 522 | NEBI | ISMAIL | YPI | | | |
| | | | 523 | XHANETA | ISMAIL | PRODANI | | | |
| | | | 524 | SUHELA | XHEVDET | LIBOHOVA | | | |
| | | | 525 | TEUTA | SKENDER | FOR A | 266.70 | 14,192 | 3,785,006.40 |

**QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN , ZONA KADASTRALE 8526**

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ENVER | QEMAL | SULA | 526 | LEJLA | ALI | KRYEMADHI(MARKU) | 30.70 | | 391,854.80 |
| ERIONA | TURABIN | MUJOLLARI | 527 | SAIBE | ALI | KRYEMADHI(GOGA) | | | |
| FATMIRA | BAJRAM | MUJOLLARI | 528 | SUZANA | ALI | MURATAJ | | | |
| ARMAND | TURABIN | MUJOLLARI,ETJ | 529 | VJOLLCA | ALI | KRYEMADHI | 164.40 | 12,764 | 2,098,401.60 |
| ENVER | QEMAL | SULA | 530 | AGRON | SKENDER | HAXHIHYSENI | 282.70 | 12,764 | 3,608,382.80 |
| | | | 531 | EDUART | SKENDER | HAXHIHYSENI | | | |

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit ($m^2$) | Çmimi (leke/$m^2$) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 532 | MAMICA | SOKOL | GRABOCKA | | | |
| | | | 533 | NADA | ALI | SKIKULI | | | |
| | | | 534 | REZARTA | SOKOL | GRABOCKA | | | |
| | | | 535 | TAJAR | ALI | QERFOZI | | | |
| DILAVER | BAJRAM | SHULI | 536 | MUHARREM | RAKIP | SINANI | 359.00 | 12,764 | 4,582,276.00 |
| FAIK | RIZA | QYRA | 537 | ISMAIL | XHEMAL | BERISHA | 317.2 | | 4,048,740.80 |
| RUST | DAN | ZENA | 538 | ENGJELLUSHE | XHEMAL | KOÇIU | 299.2 | | 3,818,988.80 |
| NDRIÇIM | HAMIT | BLLOSHMI | | | | | 434.3 | | 5,543,405.20 |
| FIQIRETE | SABRI | JANÇE | | | | | 297.7 | 12,764 | 3,799,842.80 |
| BAFTJAR | NAZIF | TOROMANI | | | | | 238.5 | | 3,044,214.00 |
| FIQIRETE | SABRI | JANÇE | | | | | 140.1 | | 1,788,236.40 |
| VEHAP | ILJAS | DEHARI | 539 | GEZIM | KAMER | MERKO | 47.4 | 12,764 | 605,013.60 |
| BEKTASH | RIZA | QYRA | | | | | 21.5 | | 274,426.00 |
| FIQIRETE | SABRI | JANÇE | | | | | 9.5 | | 121,258.00 |
| ANDERIJE | ISTREF | KULLOLLI | | | | | | | |
| ALBANA | HAZIS | KULLOLLI | | | | | | | |
| GEZIM | HAZIS | KULLOLLI | | | | | | | |
| ELTON | HAZIS | KULLOLLI | | | | | | | |
| TRANDAFILE | HAZIS | KULLOLLI | 540 | FAIK | SHYQYRI | BUZANI | 8.7 | 12,764 | 111,046.80 |
| | | | 541 | ABDULLAH | | QAFLESHI | | | |
| | | | 542 | AZMI | | QAFLESHI | | | |
| DILAVER | KADRI | DISHANI | 543 | MURAT | MAHMUT | QAFLESHI | 13.40 | 12,764 | 171,037.60 |
| NDRIÇIM | HAJDAR | AHAMTI | | | | | 381.50 | | 4,869,466.00 |
| ILMI | NUREDIN | KASA | | | | | 324.60 | | 4,143,194.40 |
| ARIAN | NUREDIN | KASA | 544 | RRAPUSH | | TABAKU | | 12,764 | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ILMI | NUREDIN | KASA | 545 | HATIXHE | MEHMET | KRYEMADHI(MULLAJI) | | | |
| ARIAN | NUREDIN | KASA | 546 | FLUTURAKE | MEHMET | KRYEMADHI | | | |
| | | | 547 | MYNEVER | MEHMET | CANKJA | | | |
| | | | 548 | ARDJANA | XHEVDET | BRAJA | | | |
| | | | 549 | SKENDER | ABDYL | TRUNGU | | | |
| | | | 550 | FATMIRA | ABDYL | TRUNGU | | | |
| | | | 551 | HAMIDE | ABDYL | TRUNGU | | | |
| | | | 552 | PRANVERA | | TRUNGU | 27.50 | 12,764 | 351,010.00 |
| XHEMALI | DEMIR | KURTI | 553 | AGRON | SELMAN | MYFTARI | 497.10 | 12,764 | 6,344,984.40 |

**QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN , ZONA KADASTRALE 8527**

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit ($m^2$) | Çmimi (leke/$m^2$) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 554 | OMER | AZMI | STRINGA | | | |
| | | | 556 | ARBEN | AGRON | STRINGA | | | |
| | | | 557 | ERVIN | MUSTAFA | LAMÇJA | | | |
| | | | 559 | GLADIOLA | AGRON | STRINGA(DAKLI) | | | |
| | | | 560 | LUMNIJE | ZIJA | LUNIKU(LAMÇJA) | | | |
| | | | 562 | MERITA | MUSTAFA | LAMÇJA(DURO) | | | |
| | | | 563 | PRANVERA | AZMI | HAMZAJ(STRINGA) | | | |
| | | | 565 | VJOLLCA | ZIJA | LUNIKU | | | |
| | | | 566 | LILJANA | MUSTAFA | LAMÇJA\|(BIÇOKU) | | | |
| | | | 568 | BENON | MUSTAFA | LAMÇJA | | | |
| | | | 569 | BRIKENA | SEZAI | HAXHIADEMI(BAXHAKU) | | | |
| PETRIT | SHABAN | PISHA | 571 | ALEMSHA | AZMI | BOLLANO(STRINGA) | 336.10 | 12,764 | 4,289,980.40 |
| FYQYRI | REXHEP | LALOSHI | 572.127273 | AGRON | TEKI | TELA | | | |
| FATMIR | QAMIL | LALOSHI | 573.618182 | ANITA | MASAR | ALICKA | | | |
| NEKI | FERIT | FERRA | 575 | FELATUN | MAZLLEM | KARAISKAJ | | | |
| | | | 577 | GJERAK | MAZLLEM | KARAISKAJ | | | |
| | | | 578 | HAJALI | ISMAIL | YPI | | | |
| | | | 580 | LAVDIJE | SKENDER | KALASA | | | |
| | | | 581 | NEBI | ISMAIL | SEFA | | | |
| | | | 583 | NESFIJE | TEKI | SELENICA(TELA) | | | |
| | | | 584 | SHAZIVAR | MASAR | KARAOSMANI | | | |
| | | | 585.545455 | SHEGUSH | MASAR | KOSOVA | | | |
| | | | 587.036364 | SUHELA | XHEVDET | LIBOHOVA | | | |
| | | | 589 | TEUTA | SKENDER | FORA | | | |
| | | | 590 | XHANETA | ISMAIL | PRODANI | | | |
| | | | 592 | EDMOND | TEKI | TELA | | | |
| | | | 593 | BULENT | TEKI | TELA | 773.70 | 12,764 | 9,875,506.80 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| AGIM | JAHO | ÇEKOJA | | | | | | | |
| PETRIT | HAZIZ | KOLONJARI | | | | | | | |
| MUSTAFA | SHERIF | KROZI | | | | | | | |
| AGRON | HALIL | KUCI | | | | | | | |
| SPARTAK | SHEFQET | KORRA | | | | | | | |
| YLLI | MURAT | KOLONJARI | | | | | | | |
| FADIL | MURAT | KOLONJARI | 594 | GJYLSYME | RRAHMI | BASHA | 2,167.18 | 12,764 | 27,661,885.52 |
| | | | 595 | DALIP | KADRI | BAKALLI | | | |

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit ($m^2$) | Çmimi (leke/$m^2$) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 596 | FATUSH | | BAKALLI | | | |
| | | | 597 | NASHIFER | | BAKALLI | | | |
| | | | 598 | MELEQ | | BAKALLI | | | |
| | | | 599 | KADESHE | | BAKALLI | | | |
| | | | 600 | MUSA | | BAKALLI | | | |
| | | | 601 | SHEJNAZ | | BAKALLI | | | |
| | | | 602 | BURBUQE | | BAKALLI | | | |
| PETRIT | HAZIZ | KOLONJARI | 603 | DRITAN | SADIK | ÇENGELI | 93.80 | 12,764 | 1,197,263.20 |
| XHEVAHIR | SHEME | MUZHAQI | 604 | ADRIAN | DILAVER | SEJDINI | | | |
| GENCI | JAHO | MUZHAQI | 605 | BEKIM | RIFAT | KADIU | | | |
| ZENUN | JAHO | MUZHAQI | 606 | MAJLINDA | DILAVER | DUHANXHIU | | | |
| RAMAZAN | ISMAIL | SHALLA | 607 | ZAMIRA | IBRAHIM | VYSHKA | | | |
| SHEFQET | KADRI | BICJA | | | | | 1,353.20 | 12,764 | 17,272,244.80 |
| SHEFQET | KADRI | BICJA | 608 | HYSEN | IBRAHIM | NEZIRI | 371.40 | 12,764 | 4,740,549.60 |
| | | | 609 | BARDHUL | FATMIR | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 610 | BALLKYZ | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 611 | FLORESHA | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| KUJTIM | IBRAHIM | HUSHI | 612 | ARBEN | FATMIR | HAXHIHYSENI | 223.7 | 12,764 | 2,855,306.80 |
| AGIM | IBRAHIM | CORA | 613 | BARDHUL | FATMIR | HAXHIHYSENI | | | |
| SHPETIM | IBRAHIM | CORA | 614 | BALLKYZ | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 615 | FLORESHA | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 616 | ARBEN | FATMIR | HAXHIHYSENI | 237.30 | 12,764 | 3,028,897.20 |
| | | | 617 | BARDHUL | FATMIR | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 618 | BALLKYZ | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 619 | FLORESHA | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 620 | ARBEN | FATMIR | HAXHIHYSENI | 3.6 | 12,764 | 45,950.40 |
| | | | 621 | BARDHUL | FATMIR | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 622 | BALLKYZ | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 623 | FLORESHA | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| FATMIR | YMER | LEÇAJ | 624 | ARBEN | FATMIR | HAXHIHYSENI | 439.90 | 12,764 | 5,614,883.60 |
| VLADIMIR | MITRI | TOPUZI | 625 | BARDHUL | FATMIR | HAXHIHYSENI | | | |
| KUJTIM | MITRI | TOPUZI | 626 | BALLKYZ | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| FERDINANT | MITRI | TOPUZI | 627 | FLORESHA | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 628 | ARBEN | FATMIR | HAXHIHYSENI | 412.20 | 12,764.00 | 5,261,320.80 |
| ARTUR | SOTIR | DEDJA | 629 | BARDHUL | FATMIR | HAXHIHYSENI | 406.1 | 12,764 | 5,183,460.40 |

| Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar | | | Numri I Pronareve qe kompensohen | Kompensimi i Pronarëve | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emër | Atësi | Mbiemër | | Emër | Atësi | Mbiemër | Masa e kompensimit ($m^2$) | Çmimi (leke/$m^2$) | Shuma - Vlera e kompensimit (lek) |
| 1 | 2 | 3 | 9 | 10 | 11 | 12 | 15 | 16 | 17 |
| | | | 630 | BALLKYZ | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 631 | FLORESHA | ISMAIL | HAXHIHYSENI | | | |
| | | | 632 | ARBEN | FATMIR | HAXHIHYSENI | | | |

*(vijon)*

ÇMIMI

# "Testamenti" i Kutelit çmim nga Biblioteka Kombëtare

## Atalanta Pasko: Janë bashkuar disa vlera, ajo grafike dhe e ilustrimit

## Çmimin Kombëtar të Bibliofilisë "Lumo Skendo" për një votim me ilustrimet e Gazmend Lekës

Fatmira Nikolli

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë organizoi dje ceremoninë e dhënies së Çmimit Kombëtar të Bibliofilisë "Lumo Skendo" për vitin 2017. Dhënia e këtij çmimi përmbyll një varg veprimtarish kushtuar Mid'hat Frashërit a "Lumo Skendos", pseudonimi letrar me të cilin ai u identifikua kulturalisht gjatë gjithë krijimtarisë dhe veprimtarisë së tij letrare e botuese ashtu edhe patriotike, shkencore e diturore. Biblioteka Kombëtare çeli veprimtarinë kushtuar veprës së tij duke risjellë në duar të studiuesve dhe lexuesve të sotëm revistën "Diturija" në një botim bibliofilik e anastatik. Kontributit të Lumo Skendos si themelues të kësaj reviste "Monument kulture" i trashëgimisë iu kushtuan dy konferenca shkencore të organizuara nga dy Bibliotekat Kombëtare të Shqipërisë dhe të Kosovës si dhe një bibliografi e hartuar posaçërisht për revistën "Diturija" nga specialistët e BKSH. Ceremonia u zhvillua në sallën e bibliotekës që mban emrin e tij. Me Çmimin Kombëtar të Bibliofilisë "Lumo Skendo" për vitin 2017 u vlerësua shtëpia botuese "Kuteli" me motivimin: Për botimin e hijshëm e nostalgjik, ilustruar grafikisht nga mjeshtri Gazmend Leka, të përmbledhjes me rrëfenja "Tregime të moçme shqiptare", një prej veprave më mbresëlënëse e më të dashura të letërsisë shqipe të çdo moshe, trashëgim monumental nga pena e rrëfimtarit mjeshtëror Mitrush Kuteli.

Drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare, Persida Asllani, i dorëzoi çmimin Atalanta Paskos, themeluese e Shtëpisë botuese "Kuteli" dhe vajza e shkrimtarit Mitrush Kuteli. Pasko, pasi falenderoi për "vlerësimin e dhënë me akordimin e këtij çmimi kaq domethënës" u shpreh se "në këtë botim janë bashkuar disa vlera, ajo grafike dhe e ilustrimit me rrëfimtarinë dhe tregimet, por edhe përkushtimi dhe puna e palodhur e Elzana Agollit dhe shtypshkronjës "Mali Pleshti", që solli këtë botim cilësor". Edicioni i vitit 2017 i përmbledhjes "Tregime të moçme shqiptare" nga shtëpia botuese "Kuteli" është një botim special që përkon edhe me 110-vjetorin e lindjes së shkrimtarit. Çmimi Kombëtar i Bibliofilisë "Lumo Skëndo" nga viti 2013 i është besuar Biblio-tekës Kombëtare të Shqipë-risë. I akorduar për herë të parë në vitin 2006, është çmimi i vetëm që nxit dhe mbështet cilësinë estetike të botimeve shqiptare. Ky çmim i shërben vlerësimit dhe stimulimit të botimeve me vlera të spikatura bibliofilike dhe intelektuale, nëpërmjet evokimit të personalitetit të kulturës dhe të mendimit shqiptar Lumo Skëndo (Mit'hat Frashëri), veçanërisht si themelues i bibliofilisë shqiptare. Mbas ceremonisë së Çmimit të Bibliofilisë "Lumo Skendo" 2017 në Sallën Franceze të Leximit u zhvillua: Forumi "Poetika shqipe – trashëgimia shqipe" organizuar me rastin e botimit të librit "Testa-menti", të akademik Sabri Hamitit botim i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, me pjesëmarrjen e akademikes Floresha Dado dhe studiuesve të njohur Bashkim Kuçuku, Nysret Krasniqi, Dhurata Shehri, Kastriot Gjika etj. Libri "Testamenti" vjen si një reflektim i vijueshëm me shkrime kritike për letërsinë shqipe, të shkruara gjatë këtyre viteve të fundit nga autori. Këto shkrime klasifikohen prej tij në tri pjesë: *I. Lirika shqipe, II. Leksione* dhe *III. Testamenti*, që me ide e procedime letrare lidhen domosdoshmërisht në një sistem me librat pararendës të tij si: *Bioletra, Tematologjia, Albanizma, Utopia letrare.* Me këtë libër të fundit ai përmbyll "pesëlibërshin" që synon titullin e përbashkët "Poetika shqipe" apo, siç e shpreson vetë autori "një filozofi të letërsisë".









**HAMITI PËR "TESTAMENTIN"**

Libri *Testamenti* përmban shkrimet kritike për letërsinë shqipe, të bëra në vitet e fundit. Këto shkrime klasifikohen në tri pjesë: *I. Lirika shqipe, II. Leksione* dhe *III. Testamenti*, që me ide e procedime letrare lidhen domosdoshmërish në një sistem me librat pararendës: *'Bioletra', 'Tematologjia', 'Albanizma', 'Utopia letrare'.*

Në pjesën e parë, *'Lirika shqipe',* trajtohet lirika si thelb i artit letrar, që si qenie, si thurje e si komunikim shfaqet në trajtë të klithmës emocionale, në trajtë të thirrjes identitare e, më rrallë, në trajtë të shqiptimit metafizik. Që nga zanafilla dy trajtat e para janë pranuar më lehtë e janë interpretuar më shtruar. Këtë herë është bërë përpjekje për interpretim të poezisë së mendimit, lirikës metafizike, të autorëve shqiptarë. Profecia poetike e Pjetër Bogdanit, lirika romantike e Jeronim de Radës, doktrina letrare e Naim Frashërit, lirika klasike e Ndre Mejdës, testamenti lirik i Gjergj Fishtës, lirika moderne e Lasgush Poradecit, misioni poetik i Esad Mekulit, urtia poetike e Azem Shkrelit. Është parë domosdoshmërish edhe thelbi identitar e shqiptimi elegjiak i kësaj lirike, që merr forma të ndërliqshme poetike.

Në pjesën e dytë, *Leksione,* (duke u nisur nga thelbi i nocionit *leksion,* së pari, si *zgjedhje* e *lexim* dhe së dyti, si *ligjërim)* janë trajtuar fenomene karakteristike të letërsisë shqipe. Te kapitulli *Gjergj Kastrioti (Variacione për heroin nacional)* kërkohet paradigma letrare e historisë dhe e letërsisë së identitetit: nisur nga amëza letrare, duke kaluar nëpër format e letërsisë në poezi, në dramë e në prozë, të autorëve të njohur shqiptarë. Te *'Ujdhesa e shpëtimit'* diskutohet drama e krijuesit dhe veçoria e krijimit letrar në diasporë. Në *'Lamberci e Çabej': për letërsinë shqipe,* bëhet ballafaqimi i dijetarit gjerman e dijetarit shqiptar rreth zanafillës dhe zhvillimit të letërsisë shqipe.

Në kapitullin *'Një histori alternative e letërsisë shqipe',* rroket në trajtë teorike e në interpretim praktik letërsia shqipe e shkruar në gjuhë të huaja, duke tematizuar dhe mënyrën e komunikimit të saj në sistemin e tërësishëm të kësaj letërsie. Në një kapitull trajtohet letërsia dokumentare, si letërsi e logorit, e Zef Pllumit, duke lexuar edhe veprat postume të tij. Një kapitull tjetër ruan në vëmendje murgun letrar Anton Pashkun, duke interpretuar tekstet e tij më të fundit, dhe duke i vënë në relacion me prozën e tij moderne dhe letërsinë bashkëkohore shqipe. *Letërsia si kujtesë,* e trajtuar si fenomen universal letrar, vë në dukje trashëgiminë kulturore individuale si thelb të ligjërimit letrar te autorë të shekullit njëzet. Trajtesa *Ego: romani bashkëkohor* tematizon ballafaqimin e autorit me lexuesin në tekstin e romanit shqiptar të fillimit të shekullit XXI. *Mësimi i letërsisë* diskuton letërsinë si vlerë fondamentale shpirtërore të kombit dhe kompleksivitetin e mësimit të saj në katedra, duke tejkaluar rrezikun e klishetizimit të formave letrare, të cilat janë të hapura përjetësisht dhe pranohen në formë të varianteve nëpër sensibilitetin e brezave. Në pjesën e tretë, *'Testamenti',* bëhet shenjimi i të dhënave letrare në kohë, autorë, vepra, stile, individualitete, formacione, të gjitha në një sistem të lidhur për të krijuar raportin e komunikimit të tërësishëm letrar brenda sistemit të letërsisë nacionale.



Në foto: **Mitrush Kuteli**

**NJOFTIM**

Në datë **18.12.2018 në orën 16.00** në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Irisa Tereziu PF me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njësia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Truall+Ndertesë" me sip. Trualli 300 m2 dhe sip.ndërtese 120 m2, me nr.pasurie 522/10/1, volum 6, faqe 2, zonë kadastrale 1167, ndodhur ne Bërxull, Tiranë.**Cmimi ne ankand te parë është në vlerën 3,940,248 (tre milion e nëntëqind e dyzet mijë e dyqind e dyzet e tetë) lekë.**

**NJOFTIM**

Në datë **19.12.2018 në orën 16.00** në zyrën e përmbaruesit gjyqësor privat Irisa Tereziu PF me adresë në "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njësia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Truall+Ndertese" me sip. Trualli 220 m2 dhe sip.ndertese 97 m2, me nr.pasurie 11/23, volum 10, faqe 229, zone kadastrale 8503, ndodhur ne Lagjia "Jani Vruho", Berat.**Cmimi ne ankand te parë është në vlerën 3,280,000 (tre milion e dyqind e tetedhjete mije) lekë.**

**SHPALLJE ANKANDI**

**Zyra Permbarimore "E.G Bailiff Service"** me përmbarues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tiranë, njofton se më date **24.12.2018 ora $8^{00}$ - $16^{00}$** në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme, **Arë** me sipërfaqe totale **1500 $m^2$** me numër pasurie 6/90, volumi 9, faqe 174, zona kadastrale 1879, e ndodhur në Grykë Lumi, Lezhë në pronësi të Z.Gjon Zef Gjoka me vlere fillestare në ankand 15.876 (Pesëmbëdhjetmijë e tetëqind e shtatëdhjet e gjashtë) EUR.
**Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com**

# BLUE TOOTH

Thashetheme

MADE IN ALBANIA

Nr. 639

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 15 Dhjetor 2018




# MBYLLET "DANCE WITH ME"?

## ALKETA VEJSIU:

## Që tani kontaktojmë VIP-at për sezonin tjetër!





# SONI MALAJ

## Vjen në "Fest 57" me "Më e fortë": Kjo këngë është himn i karrierës sime artistike

*Këngëtarja e njohur, në festivalin e RTSH-së me një këngë autobiografike e një mesazh të fortë*

## Për herë të parë në festival

# KLODIANA VATA:

## Dëshiroj ta përfaqësoj vendin në Eurovizion"





### Këngëtarja e njohur, në festivalin e RTSH-së me një këngë autobiografike e një mesazh të fortë

# SONI MALAJ

## vjen në "Fest 57" me "Më e fortë": Kjo këngë është himn i karrierës sime artistike



Është rikthyer në skenë një nga këngëtaret më të dashura të publikut. Më një këngë në të cilën shfaqet më e fortë dhe më e plotësuar se kurrë në çdo dimension të jetës së saj. Po

Pamela Aliaj

flasim pikërisht për Soni Malaj, këngëtarja bukuroshe, e cila është një prej protagonisteve kryesore në Festivalin e 57-të të RTSH-së. "Më e fortë" titullohet kënga me të cilën ajo do të konkurrojë këtë vit dhe ende pa nisur festivali, ajo ka arritur të ngrejë peshë zemrat e audiencës. Hiti ka rezultuar një sukses absolut deri tani dhe për këtë flasin








> *"Mesazhi është për të gjithë ato femra që s'kanë bërë kompromise në jetën e tyre"*

shifrat, që e rendisin në një nga pretendentet kryesore për të fituar trofeun e këtij edicioni të festivalit të RTSH-së. "Më e fortë" është kompozim i Irkenc Hykës dhe vetë Sonit, ndërsa teksti është i Big Bastës dhe Petro Xhorit. Në një rrëfim për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" lidhur me këtë këngën e re dhe me impaktin që ajo ka pasur tek audienca deri më tani, Soni ka thënë:

"Audienca ose më mirë, publiku e ka pritur në mënyrë të shkëlqyer këngën e festivalit të madh, 'Më e fortë', aq sa jam surprizuar, sepse kam marrë mesazhe nga shumë femra që kanë qarë kur e kanë dëgjuar këngën, janë emocionuar. Nuk po përmend emra, por shumë artistë dhe shumë femra që janë në 'showbiz' më kanë thënë se janë rënqethur kur e kanë dëgjuar këngën. Ndërsa disa të tjerë më kanë thënë se u është ngritur shpirti peshë kur e kanë dëgjuar, sepse është një këngë që përcjell një mesazh për të gjithë ato femra që nuk kanë bërë kompromise në jetën e tyre për të ecur përpara. E kanë bërë çdo gjë me shumë sakrificë e dhimbje, por pa humbur dinjitetin e forcën që kanë brenda vetes dhe prandaj në fund të këngës unë them: Një femër nuk është thjesht një femër"!

Ndërkaq, pyetjes lidhur me pritshmëritë e tanishme të cilat shprehen në shifra ku shihet se mund të synojë edhe Eurovizionin, lidhur me rrëmbimin e vendit të parë Soni është shprehur:

"Unë do të isha vërtet shumë e lumtur nëse juria dhe publiku do të mendonin të më dërgonin mua si përfaqësuese të Shqipërisë në Eurovizion. Një gjë është e sigurt, që unë do të jap maksimumin si në performancë vokale, ashtu edhe në atë skenike. Çfarëdo që të ndodhë, unë jam shumë e lumtur për këngën që kam, e dua atë shumë dhe dua që të jetë himni i karrierës sime, kjo këngë dhe ky mesazh. Pasi siç e kam deklaruar, është një këngë autobiografike. Autorët e këngës, Big Basta dhe Petro Xhori e kanë përshtatur tekstin e këngës në bazë të eksperiencës sime jetësore dhe artistike dhe për këtë jam shumë e lumtur që në karrierën time më është shënuar kjo këngë dhe dua ta mbaj si himnin e karrierës sime artistike".

# Jo më baterist? Bashkëshorti i Tunës bëhet pjesë e ushtrisë së Kosovës

Ditën e djeshme pas një zhurme shumë të madhe që bëri, u krijua FSK dhe të shumta ishin urimet nga të gjitha anët e botës ku ndodheshin shqiptarë. Në sy kanë rënë urimet e vip-ave, të cilët mezi e prisnin këtë moment në Kosovë. Por ajo që asnjë nga ne nuk e priste është pjesëmarrja e bashkëshortit të Tunës, Patrisit në ushtrinë e Kosovës. Altuna Sejdiu është njëra nga këngëtaret e estradës kosovare e cila komentohet në media rozë. Ajo bashkë me bashkëshortin e saj Patris Berishën, janë aktivë në rrjete sociale të cilët ndajnë postime të shumta. Patrisi ka habitur me disa foto, të cilat ai i ka publikuar në rrjetin e vet në 'Instagram'. Një ushtar vërtet tërheqës!









# Jo më e fshehtë! Ja çfarë gjinie ka fëmija i Loredanës dhe Mozzikut

Para disa muajsh u zbulua shtatzënia e këngëtares Loredana, e cila edhe pse pa celebrim pret një fëmijë të reperit Mozik. Së fundmi është zbuluar edhe gjinia e fëmijës së saj. Sipas postimeve që bënte Loredana, foshnja e cila edhe pak vjen në jetë është vajzë. Kjo gjë është konfirmuar edhe njëherë dje me anë të një postimi që artistja ka bërë në Instagram. Ajo sërish ka publikuar një foto ku shihet një nënë me vajzën e saj. Do të jetë vërtet një vogëlushe shumë e bukur! Mezi presim ta shohim.



# "S'jam e kënaqur me rezultatin, do e bëj prap", Roza Lati i rikthehet operacioneve plastike

Pas 2 vitesh që kishte bërë operacionin në hundë, moderatorja e njohur shfaqi një mospëlqim të rezultatit të arritur. Së fundmi, Roza Lati u shpreh se në fakt nuk ishte edhe shumë e kënaqur me hundën e re, pasi kishte ndryshuar të gjithë portretin e saj. E ftuar në emisionin "Shiko kush Luan", Roza Lati shprehet se nuk do e lë me kaq, por po mendon të realizojë një operacion të dytë për të arritur rezultatin që ajo kërkon, sepse nuk është e lumtur. "Ndërhyrje që dua ta bëj prap, sepse nuk po ndihem mirë, është hunda" – tha Roza Lati. E ftuar në emision ka qenë edhe ëma e saj, Rita Lati, e cila ka zbuluar se përpiqet të ndikojë në jetën romantike të së bijës. "Lidhej me njërin që nuk më zinte gjumi fare, ose do e ndaja o vdiqa" – tregoi Rita Lati.





# Skandal! Miss Shqipëria s'di datën e Pavarësisë! Fjalët e Petri Bozos nuk priteshin

Ditën e djeshme miss-et e përzgjedhura për kalendarin fotografik të vitit 2019 kanë qenë të ftuara në emisionin " Trokit" së bashku me producentin e njohur Petri Bozo. Në fillim biseda ishte mjaft miqësore dhe e këndshme. Por ndërsa Alba Bajrami, e cila është kurorëzuar "Miss Shqipëria 2018" po fliste për eksperiencën e përjetuar në konkursin ndërkombëtar të bukurisë, ku kishte marrë pjesë, moderatori Ermal Peçi e ndërpret si për ta ngacmuar, dhe e pyet se kur është data e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Vajza përgjigjet: 28 nëntor, por pa gjetur vitin. Fjalinë e saj e plotëson Petri. Ermali e ngacmon edhe atë duke e pyetur përse ngecin këto vajza te historia? Dhe producenti përgjigjet: "Po prandaj po bëhen këto të shkollave se ka ikur shkolla për l*sh. Nuk u mësojnë as histori, as gjeografi. Kur unë u them do shkojmë në filan vend thonë 'Nuk e dimë ku bie'. Nuk njohin gjeografinë e Shqipërisë, harroje pastaj të botës, ka ngelur e gjitha te celulari, fillojnë kërkojnë në google edhe për të lidhur një fjali!".

# E konfirmuan lidhjen? Ç'po ndodh me Florin dhe Kejsi Tolën?

Së fundmi fituesi i "Kënga Magjike 2018" ka publikuar një foto të Kejsit në 'Instagram' shoqëruar me një zemër. Fotoja duket të jetë shkrepur në një studio muzikore ndoshta në ambientet e "Threedots" dhe këngëtarja e "Më ke mua" shfaqet duke qeshur vesh më vesh. Por spekulimet nisën në puntatën e post-"Kënga magjike" në "E diela Shqiptare" kur në momentin që 26-vjeçarja po performonte këngën e saj "Më ke mua" iu bashku në performancë Flori Mumajesi edhe gjatë kërcimit të baladën dyshja dukej shumë e afërt me njëri-tjetrin. Nuk dihet vërtet se çfarë qëndron mes dy artistëve, por kujtojmë se kohëve të fundit dyshja qëndron gjithnjë e më shumë në shoqërinë e njëri-tjetrit pas përpara se Flori të krijonte 'këngën e jetës' (siç e ka cilësuar Kejsi këngën konkurruese me titull "Më ke mua" të Kënga Magjike) ata kanë bashkëpunuar gjatë kësaj vere dhe studioja muzikore e Mumajesit krijoi për këngëtaren këngën e njohur "U rritëm". Të jenë të lidhur vallë apo thjesht shtysë për pak thashetheme rozë?





# Sa shpejt harroi Mimozën! Seldi konfirmon lidhjen me vajzën e këngëtarit të njohur?

Edhe pse ka javë që gumëzhihet lartë e poshtë nuk është konfirmuar përfundimisht. Kësaj radhë është vetë këngëtari Seldi, i cili konfirmon lidhjen me vajzën e këngëtarit të njohur, Sabian. Prej pak kohësh qarkullojnë fjalë për një marrëdhënie më shumë se shoqërore mes Seldi Qalliut dhe Keisi Mejdinit. E tani që lajmi për një projekt të përbashkët muzikor mes tyre është konfirmuar, Seldi po na jep indicie që edhe pretendimi për një histori mes tyre mund të jetë i vërtetë. Të paktën kështu mendojmë pasi ai ka postuar në story-n e tij të Instagramit këtë video të Keisit duke u bërë nuse, me mbishkrim "Vajza ime e bukur". Kejsi është vajza e këngëtarit të njohur nga Shqipëria, Sabianit.




# Largohet nga "Voice of Kids", ja ku do shfaqet Eneda Tarifa këtë vit

Ajo ka provuar për vite me radhë të jetë edhe moderatore duke kujtuar këtu eksperiencën e saj në "Portokalli". Mesa duket, Eneda Tarifës i është besuar edhe njëherë një eksperiencë prezantimi këtë herë në TVSH. Por sipas një media rozë së fundi u zbulua se Eneda do të drejtojë programin e fundvitit në këtë televizion. Pak kohë më parë këngëtarja ishte pjesë e koncertit "Divat" së bashku me këngëtare të tjera të njohura si Irma Libohova, Besa Kokëdhima dhe Rovena Dilo. Do të jetë vërtet një show i veçantë e plot surpriza!





# London Noor mbush 2-vjeç, momentet e ëmbla të festës

Para pak ditësh vogëlushi i trashëgimtares së Top Channel Sara Hoxha dhe moderatorit Ledion Liço, London ka festuar 2-vjetorin e lindjes. Për këtë arsye Sara publikoi një foto të vogëlushit nga festa e organizuar për të ku shohim se arredimi është menduar si një ylber tullumbacesh. "Arush Dudushi jonë u bë 2 vjeç sot,"-shkruan Sara krahas fotos së publikuar në rrjete sociale ku shohim të voglin London Noor mjaft të rritur. Gjithashtu, pjesë e festës ka qenë edhe Lori, e cila ka ardhur nga Londra për këtë ditë të rëndësishme. Sa shpejt ikin vitet!



# Rishfaqet Elvana Gjata, ja datat e turit në Amerikë

Pas ngjarjes në ish-Bllok, ku mbeti një person i vrarë dhe një tjetër i plagosur, këngëtarja Elvana Gjata u 'zhduk' përkohësisht. Por ndërkohë së fundmi Elvana është bërë e 'gjallë' nëpërmjet një postimi. Këngëtarja do të rikthehet në fillimet e vitit të ardhshëm me një super tur muzikor në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në kanalin zyrtar të artistes në 'YouTube', kanë filluar të shiten biletat për koncertet që pritet t'i mbajë Elvana më 3 dhe 6 maj të vitit 2019, në New York dhe Filadefia. Koncerti i datës 3 maj do të mbahet në një lokal në parkun e Asbury-t rreth orës 19:00. Ndërsa, koncerti në Filadelfia që do të organizohet në 6 maj do të fillojë rreth orës 20:00 të mbrëmjes. I shumëpritur ky rikthim apo jo? Të shohim si do të shfaqet këngëtarja.





Debati me Robert Aliajn, flet moderatorja: Shumë mirë që zgjon diskutime!

# Mbyllet "Dance With Me"?

## Reagon Alketa Vejsiu: Që tani kontaktojmë VIP-at për sezonin tjetër!

### *"Surpriza në finale, një prej tyre është Paola Perego"*

Pamela Aliaj

Para pak ditësh në media qarkulloi lajmi se moderatorja e "show"-t të njohur e "Dance With Me" kishte thënë se ky emision do të përfundonte me këtë sezon të pestë. Për të zbuluar më tepër, Alketa Vejsiu ka folur për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" si qëndron e vërteta e fjalëve të saj në puntatën e fundit. Gjithashtu, ajo që u vu re natën e kaluar ishte edhe debati që moderatorja pati me një nga anëtarët e jurisë, Robert Aliajn. Në fjalë e sipër u duk se atmosfera u nxeh, gjë që nuk ishte parë më parë. Alketa foli lidhur me këtë sekuencë gjithashtu se ishte mëse normale dhe se e vlerësonte shumë Aliajn. Pas kërcimeve të konkurrentëve, shpeshherë hapet debat në "Dance with me", por këtë herë shkak ishte thjesht një kompliment i moderatores Alketa Vejsiu drejtuar Robert Aliajt. "S'kemi pse të jemi fals, pse të mos jemi të sinqertë", i tha Roberti Alketës. "Unë të bëra një kompliment, po flas shqip jo kinezçe. Mbështetu tek e mira, mos shiko busull publikun", ia ktheu Alketa. "Alketa ke



pasqyrën përpara, më duket po flet për veten", i tha Roberti. "Nuk u morëm vesh, ishte moment konfuz", u shpreh Alketa për të mbyllur debatin, por Valbona ndërhyri dhe tha: "Alketa mos iu fut lojës së Bertit se kemi një spektakël për të bërë". "O Valbona nuk i futem lojës së Robertit unë jo", ia ktheu moderatorja. "Robert na fëlliqe, tani t'i japim situatës ngjyrat e kër-







cimit", përfundoi Alketa. Për më tepër ndiqni reagimin e moderatores si më poshtë:

**Është e vërtetë që përfundon këtë vit? Nuk do të ketë një sezon tjetër?**

Uaaa do vazhdojë patjetër "Dance With Me". Pse ta mbyllim? Ky është një program shumë i suksesshëm, s'ka pse ta mbyllim, biles që tani kemi nisur të kontaktojmë VIP-at e sezonit tjetër. Vazhdojmë në shtator të vitit tjetër me "Dance With Me 6". Ndërsa në serinë e fundit do të jetë e ftuar surprizë moderatorja Paola Perego, personazhi i "RAI"-it dhe "Mediaset", që anonçova edhe natën e kaluar. Ajo do jetë e ftuara speciale në finale.

**Është i vërtetë debati që patët me Robert Aliajn? Si i keni marrëdhëniet me të?**

Nuk kam pasur debat me Robert Aliajn. Unë i kam të shkëlqyera marrëdhëniet me të. Ai është një personazh i lirë, i pacensuruar, shprehet e unë i kthej përgjigje. Kaq! Shumë mirë që ka zgjuar ndonjëherë diskutime apo debat mes nesh, sepse do të ishte shumë i vakët programi. Pavarësisht të gjithave, këto diskutime janë konstruktive në fund të ditës.




Flet këngëtarja e këngës "Mbrëmje pa fund": Është pritur mirë, sidomos në rrethin e muzikantëve

# Për herë të parë në "Fest 57", Klodiana Vata: Dëshiroj ta përfaqësoj vendin në Eurovizion

*"Tani e ndjej veten më të pjekur dhe të përgatitur nga ana vokale"*

Pamela Aliaj

Jo vetëm zërat e njohur konkurrojnë këtë vit në festivalin e shumëpritur të RTSH-së, "Fest 57", por edhe shumë të rinj, të cilët aspirojnë për të na përfaqësuar sa më mirë, pse jo edhe në Eurovizion. Një zë i tillë i veçantë është edhe ai i Klodiana Vatës, këngëtares nga Shkodra. Në një intervistë për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", këngëtarja është shprehur lidhur me përgatitjet përpara netëve 'live' si dhe projektet e saj të mëvonshme. Klodiana ndër të tjera shprehet se dëshira e saj është të fitojë këtë kompeticion për të përfaqësuar Shqipërinë në Eurovizion.

**Si lindi ideja e këngës? Nga u frymëzuat?**

Teksti është shkruar nga Jorgo Papingji dhe ai është frymëzuar nga muzika e kompozuar nga Edmond Zhulali.

**Si është pritur nga publiku dhe cilat janë reagimet që ju kanë dhënë lidhur me të?**

Reagimet kanë qenë shumë pozitive, por ajo që më gëzon më shumë është se kënga është pritur mirë, sidomos në rrethin e muzikantëve dhe atyre që e njohin muzikën.

**Pse zgjodhët të ishit pjesë e "Fest 57" të festivalit të RTSH-së e jo në një tjetër festival muzikor?**

Fazën e konkurseve unë e kam tejkaluar tashmë, pasi kam që në moshën 6-vjeçare që jam pjesë e të gjitha konkurseve që janë organizuar në Shqipëri dhe jashtë saj. Këtë vit ishte momenti që unë të konkurroja në "Fest 57", pasi tani e ndjej veten më të pjekur dhe të përgatitur nga ana vokale.

**Kur do të performoni me këngën tuaj?**

Në datat 20, 21 dhe 22 (nëse kënga kalon në finale).

**Çfarë planesh keni pas festivalit? Kur do të vijë Klodiana me një videoklip të sajin?**

Po punoj për një këngë të re, të cilën do ta sjell me një videoklip. Videoklipi i radhës do të vijë në fillimin e vitit 2019.

**A mendoni se do të rrëmbeni kupën për në Eurovizion?**

Është hera e parë që marr pjesë në Festivalin e RTSH-së dhe nuk e fsheh se dëshira ime është të fitoj për të përfaqësuar Shqipërinë në Eurovizion, por sido që të shkojë, unë jam shumë e kënaqur që jam pjesë e këtij festivali, pasi është festivali më serioz dhe me impeniativ që ka Shqipëria, pasi ka një traditë prej 57 vitesh.

**Kush sipas jush, është tjetër pretendente për fitoren, duke qenë se këtë vit ka prurje të vjetra dhe të reja. Cila nga këngët të duket pretendente për vendin e parë?**

Për të qenë e sinqertë, të gjitha këngët më pëlqejnë dhe secila ka një stil të veçantë dhe këndohen nga këngëtarë shumë të talentuar. Me këtë rast unë uroj që të fitojë më i miri dhe të na përfaqësojë denjësisht në Eurovizion.







## USHTRIA E KOSOVES
### PRO E KUNDER

‘BBC’: Tërbohen serbët. Brnabiç: Kundërpërgjigje ushtarake. Vuçiç: Rusia dhe Kina të na ndihmojnë

# Ditë historike për Kosovën, FSK-ja kthehet në ushtri

*Parlamenti miraton me unanimitet ligjin për Ministrinë e Mbrojtjes*

Kosova, shteti më i ri në Europë ka tash më ushtrinë e saj. 14 dhjetori është shënuar si ditë historike për shqiptarinë edhe pse kundërshtimet për krijimin e ushtrisë kanë qenë të shumta. Kuvendi i Kosovës miratoi tre ligjet që bëjnë të mundur transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri. Bëhet fjalë për Ligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, atë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ligjin për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Të tri këto ligje janë miratuar në parim gjatë muajit nëntor dhe më pas janë shqyrtuar nëpër komisione parlamentare. Ligji për Ministrinë e Mbrojtjes u miratua me 106 vota pro, asnjë kundër. Në sallë kanë qenë të gjitha grupet parlamentare, përveç Listës serbe. Transformimi i tërësishëm i FSK-së në ushtri është një proces që mund të zgjasë 7-10 vite. Disa ditë më parë nga Amerika në Kosovë, kanë arritur 24 automjete ushtarake "Humvee". Këto automjete i kanë kushtuar buxhetit të Kosovës rreth 7 milionë euro. FSK do të marrë edhe 27 automjete të tjera "Humvee", të cilat janë donacion nga Ushtria Amerikane. Në ditën kur Kuvendi i Kosovës pritej të miratonte ligjet për Ushtrinë, në Mitrovicën e Veriut, janë vendosur flamuj të Serbisë. Nëpërmjet këtyre tri projektligjeve, po synohet që Forca e Sigurisë së Kosovës të transformohet në një forcë me kapacitete shtesë, përfshirë edhe përgjegjësi të mbrojtjes, por pa prekur në emrin e saj.

**TËRBIMI**

BBC shkruan se Kosova është territor që mbrohet nga 4 mijë trupa të KFOR-it qëkur forcat serbe u larguan nga Kosova në vitin 1999 ndërsa kryeministrja serbe Ana Brnabic ishte aq e tërbuar nga votimi i ushtrisë sa foli për një kundërpërgjigje ushtarake. Presidenti serb kërkoi përkrahje nga Rusia dhe Kina. "Forcën ushtarake të Kosovës, Serbia e sheh si kërcënim ndaj 120 mijë pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë. Serbia nuk e njeh Kosovën që deklaroi pavarësinë e saj para dhjetë vjetësh", ka shtuar BBC. Reagim i menjëhershëm ka qenë edhe nga ana e NATO-s të cilët shprehën keqardhje për formimin e ushtrisë së Kosovës. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg sërish ka shprehur kundërshtimin e tij për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ushtri. "Më vjen keq që ky vendim është marrë pavarësisht shqetësimeve të shprehura nga NATO. Përderisa transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në parim është çështje për të cilën duhet të vendosë Kosova, ne e kemi bërë të qartë se kjo lëvizje vjen në kohën të papërshtatshme",-ka thënë Stoltenberg.



**FESTIMET**

Sheshet kryesore të kryeqytetit kosovar janë të mbushura me flamuj e njerëz që festojnë krijimin e ushtrisë së Kosovës, që në fakt, shumica e tyre e quajnë vijim i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Jemi të lumtur sa nuk bëhet më, sepse përveçse jemi shtet, kemi edhe një ushtri, ushtrinë që na çliroi nga dhuna e barbarizmi serb", - shprehen qytetarët e lumturuar.

**DAÇIÇ**

Serbia do të kërkojë mbajtjen e një takimi urgjent të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për siç thonë, shkeljen më brutale të rezolutës 1244 të KS-it të OKB-s, me vendimin e Kosovës për themelimin e Ushtrisë së Kosovës. Lajmin e ka bërë të ditur ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiç. "Ky është kërcënimi më direkt i paqes dhe stabilitetit në rajon dhe ndaj sigurisë së popullit serb që jeton në Kosovë", - ka thënë Daçiç.

## Themelimi, Rama uron me foton e Thaçit

## Krijimi i ushtrisë së Kosovës, Presidenti Meta: Vendim historik

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta e quan vendim historik krijimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës. Me një mesazh urimi ne rrjetet sociale, fill pas votimit në Kuvendin e Kosovës për themelimin e Ushtrisë, Meta thekson se kjo dëshmon qartë që Kosova është e aftë të marrë përgjegjësi të reja në ndërtimin e institucioneve demokratike. "Vendimi historik i krijimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës dëshmon qartë që Kosova është e aftë të marrë përgjegjësi të reja në ndërtimin e institucioneve demokratike dhe për të kontribuar vendosmërisht për paqen, stabilitetin e rajonit dhe fqinjësinë e mirë. Fryma euro-atlantike qëndron në themel të këtij ndryshimi historik", shprehet z.Meta. Kurse Kryeministri Rama ne mesazhin e tij pas vendimit historik të transformimit të FSK-së në ushtri të Kosovës uroi me një foto të presidentit Hashim Thaçi veshur me uniformë ushtarake. Fotoja është shkrepur dy ditë më parë teksa Thaçi vizitonte kazermën "Adem Jashari". Krah fotos, Rama shkruan fjalën urime tri herë, shoqëruar me flamujt e Kosovës, Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian.







### Koçijançiç: BE në një linjë me NATO-n për ushtrinë e Kosovës

Pas formimit të ushtrisë së Kosovës ka reaguar edhe Bashkimi Evropian. Maja Koçijançiç, zëdhënëse e Përfaqësuese së Lartë të BE-së, Federica Mogherini, ka thënë për Kallxo.com se BE-ja do të mbajë qëndrim njësoj si NATO-ja karshi kësaj ushtrie. "Kuvendi i Kosovës miratoi një legjislacion mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ashtu si NATO, Bashkimi Evropian vazhdon të ndajë qëndrimin se mandati i FSK-së duhet të ndryshohet vetëm përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe gradual në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Bashkimi Evropian pret që Kosova të vazhdojë të mbajë detyrimet e saj sipas marrëveshjes së parë të përfunduar në Bruksel në prill 2013 dhe aranzhimet e saj të sigurisë",-ka thënë Koçijançiç.



### 'Ushtria', Basha: Kombi shqiptar, më i fortë

Kreu i PD-së, Lulzim Basha uroi dje Kosovën për themelimin të Ushtrisë. Me një mesazh në rrjetet sociale, Basha e quan këtë ngjarjen e dytë të përmasave kombëtare dhe historike, pas Pavarësisë. "Urime Kosovë për Ushtrinë! Pas Pavarësisë, ngjarja e dytë e përmasave kombëtare dhe historike. Me Ushtrinë e saj Kosova do të jetë më e sigurt, rajoni më në paqe, kombi shqiptar i integruar dhe më i fortë. Nderim të rënëve për liri, mirënjohje miqve të mëdhenj që na mbështetën!",-shprehet z.Basha.

Opinioni i Ditës

# Frika ime nga ushtria



Nga Berat Buzhala

*(vijon nga faqja 1)*

...Ruajtja e kufijve të Jugosllavisë me Austrinë, Italinë, Hungarinë, Bullgarinë, Greqinë ose edhe me Shqipërinë, diku në Slloveni, Kroaci, Serbi a Maqedoni nuk më pëlqente aspak.

"Natën t'lojnë vetë, në pikë të territ..., duhesh me kanë i vëmendshëm..., nëse vjen dikush, ti duhesh me thanë dy herë 'stoj, stoj' (ndal), nëse nuk ndalet, atëherë herën e tretë duhesh me e vra...".

Veç ideja që unë të përballesha në një mal të huaj, shumë larg shtëpisë, me një person që nuk ndalet kur unë i them "stoj", e pastaj ta vras atë (ani kush se, unë?!), më trishtonte. Unë që nuk kisha guxim të flija vetëm në dhomë as në shtëpinë time, thosha vetë me vete: ta nisja një luftë diku në ndonjë bjeshkë në kufi me Austrinë! Më dukej që po llogaritej më tepër sesa duhet në trimërinë dhe burrërinë time.

"Serbët janë të poshtër, nuk na dojnë...., nuk na dojshin as kroatët qaq shumë, ama bojshin kishe na dojnë për inati të serbëve..., boshnjakët janë kanë ma të mirë..., sllovenët rrishin vetëm....", vazhdonin tregimet e kushërinjve që gjatë gjithë jetës së tyre nga Kosova ishin larguar vetëm kur kishin qenë ushtar në Bihaç, në Nish, në Novi Sad, a në Lubjanë. Prandaj, kjo gjë ndikonte që ata ta kujtonin çdo detaj të asaj aventure të tyre, edhe pas 30 vjetësh, sepse në ndërkohë nuk kishte ndodhur pothuajse asgjë e rëndësishme në jetën e tyre.

"Kur t'çojnë me bo roje, nuk bon kurrqysh me të marrë gjumi...". Kjo ishte këshilla më e rëndësishme. Le të themi kryekëshilla.

Dy herë thua "stoj", të tretën herë gjuan dhe e vret.

Për ta bërë gjithë rrëfimin edhe më të frikshëm, kohë pas kohe, kur flitej për ushtrinë, tregohej për ngjarjen e dhimbshme të një ushtari shqiptar të Kosovës, i quajtur Miftar Hasani, ngjarje kjo që kishte ndodhur në kohën e Jugosllavisë së Parë, atë në mes të dy luftërave botërore.

Miftarin, një djalë të ri, e kishin mashtruar ushtarët serbë, duke ia hequr shulin e pushkës, kur kishte shkuar për të bërë roje natën në mal, në kufi me Hungarinë, në mënyrë që pastaj të shkonin ta provokonin, të bindur që pushka e Miftarit nuk mund të punojë. Miftari e kishte vërejtur lojën që po ia gatuanin ushtarët serbë dhe e kishte huazuar një shul tjetër, nga një shqiptar tjetër, që po bënte roje pak më tutje, në të njëjtin mal dhe në të njëjtin kufi. Për këtë rast është edhe një këngë e gjatë folklorike, e cila tregon që në fund Miftari - PASIQË KISHTE THËNË DY HERË "STOJ" - i kishte vrarë personat që nuk po ndaleshin, e që ishin të sigurt që pushka e Miftari nuk do të bëjë bam. Në fund Miftari i vret provokuesit dhe arratiset në Hungari. Kjo histori është shumë më e gjatë sesa kaq, por për ta përshkruar deri në fund duhet një libër e jo një kolumne.

Përveç anëve negative, kuptohet, shqiptarët tregonin edhe sekuenca pozitive për ushtrinë. Ushqimi ishte njëra prej tyre. "Ka pas me hangër mirë", pajtoheshin të gjithë.

Mirëpo, unë, pra si fëmijë, në mes të një ushqimi të bollshëm, pasul me mish dhe të bërit roje natën, diku në male të largëta jugosllave, e zgjidhja me më shumë dëshirë që të hiqja për bukë. Edhe nëna pajtohej me mua. Baba, i cili e kishte kaluar me sukses këtë sfidë, qeshte.

Raporti i shqiptarëve dhe ushtrisë jugosllave, që njihej si Armata Popullore Jugosllave, në pjesën e dytë të viteve të '80-ta sa vinte e bëhej më i rrezikshëm. Kishte filluar të mos kishte vlerë as rregulla e artë "dy herë stoj e pastaj vrite". Tash po kryheshin vrasje pa paralajmërim.

Situata u tensionua posaçërisht kur ndodhi një krim i rëndë në një kazermë në qytetin e Paracinit, në Serbi, ku u tha që Aziz Kelmendi, një shqiptar i Kosovës, i vrau në dhomën e tyre të gjumit katër ushtarë dhe plagosi shumë të tjerë. Kjo masakër, që kurrë nuk është zbardhur si duhet, e përshkallëzoi gjithë situatën politike në Jugosllavi, edhe ashtu në degradim e sipër. Imazhi i ushtarëve shqiptarë në ushtri u rrënua. Propaganda serbe ishte e pamëshirshme. Djemtë e Kosovës që po shërbenin në ushtrinë e Jugosllavisë po kalonin në një situatë mjaft të rëndë. Në rrethana të errëta, disa ushtarë shqiptarë, po u ktheheshin familjeve në arkivole. Një prej tyre ishte edhe Jetullah Desku, nga fshati Siqevë, një fshat i afërt me Çabiqin. Si nxënës i shkollës fillore, mora pjesë në ceremoninë e atij varrimi, që ishte njëra prej më masiveve që e kam parë ndonjëherë. Jetullahu, për të cilin ushtria jugosllave thoshte që ishte vetëvrarë, ishte mbyllur në një arkivol hermetik, që nuk mund dhe nuk duhej të hapej. Ngjashëm si ky u vranë edhe disa djem të tjerë.

Pra, kjo ishte ushtria për mua si fëmijë. Ishte çdo gjë tjetër, përveçse një institucion që mund ta doje. Ajo ishte një e keqe nëpër të cilën do të duhej të kaloje. Në fillimin e viteve të '90-ta, tashmë askush nuk e kishte as iluzionin më të vogël që ushtria e Jugosllavisë ishte një ide e mirë. Për të ikur prej saj, qindra-mijëra djem, të moshës prej 18 vjeç e sipër, i mbushën autobusët, trenat dhe ikën për në Perëndim, për t'u kthyer në vendlindjen e tyre pas 10 vjetësh, kur Kosova u çlirua përfundimisht nga trashëgimtarja e asaj ushtrie, ushtria serbe.

Unë mbeta. As nuk shkova ushtar e as nuk arrita të ikja. Prej atëherë e deri më sot, rregullisht, në muhabete normale, ata që janë më të moshuar, kur fillojnë tregimet e tyre për ushtrinë, më pyesin "ti a e ki ushtrinë të kryme?". Kjo në fakt ka qenë njëra prej pyetjeve më të shpeshta që u bëhej djemve. Thuhej që "pa e kry ushtrinë nuk bëhesh burrë" e së këndejmi nuk ka as nuse e as martesë. Zakonisht ata që nuk ishin kualifikuar për të shkuar ushtar, konsideroheshin si persona të paaftë mentalisht. Për t'u kualifikuar për të qenë i paaftë nevojiteshin të kaloheshin disa teste te psikiatri. Secili i ka pasur në familjet tona disa djem që kishin bërë gjithçka që ishte në mundësitë e tyre për ta bindur psikiatrin që janë "nesposoban" (të paaftë për ushtri). Edhe këto kanë qenë tregime të lezetshme dhe plot humor. Tregohej se si filan personi, kur është ishte paraqitur te mjeku, e kishe ndezur cigaren kah bishti, ose ishte ulur në dysheme në vend të ulëses, ose kishte bërë grimasa të ndryshme. Disa prej tyre kishin pasur sukses në aktrimin e tyre - nëse kishte qenë aktrim - e disa prej tyre kishin dështuar. Mirëpo, në përgjithësi nuk ka qenë ide e mirë që të shmangesh nga përfundimi i shërbimit ushtarak, pa marrë parasysh peripecitë. Ushtarët përcilleshin për në ushtri me shumë fanfare, e njësoj edhe priteshin prej atje kur ktheheshin. Krejt çka mbetej pastaj për të ishte edhe faza finale e burrërimit të tij: martesa.

Testin e parë të aftësisë së tyre mashkullore për t'u martuar, këta djem, si duket e kalonin gjatë kohës kur ishin në ushtri. Në kazermat jugosllave, këta djem, kështu së paku na tregonin, i krahasonin organet e tyre mashkullore me pjesëtarët e kombeve të tjera të Jugosllavisë. Me plot mburrje tregonin, kur ktheheshin, se askush nuk mund të matej me shqiptarët në këtë drejtim. Unë jam frikësuar që edhe këtu do ta ul mesataren e kombit tim. (Po shpresoj që nuk keni arritur deri këtu me lexim.)

Unë jam i bindur që djemtë, tash edhe vajzat, që Kosova prej sot do t'i quajë ushtarë të saj, nuk do t'i kenë këto trauma. Së paku shpresoj që do t'u ofrohet pak më shumë privatësi kur bëjnë dush.

Urime!

BalkanWeb.com
AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.
MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE
MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinioni i Ditës

# Shërbim bankar edhe në zonat rurale




Nga Gent Sejko

*(vijon nga faqja 1)*

...tona, me qëllim arritjen e objektivave të përbashkëta mbi remitancat, por dhe më gjerë, me Diasporën. Sot, një vit nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit, kam kënaqësinë të përmend se materializimi i këtyre përpjekjeve është reflektuar në ndërmarrjen e një sërë angazhimesh dhe projektesh në zbatim të objektivave të synuar, të cilat do të prezantohen në vijim.

Rëndësia e remitancave në ekonominë shqiptare, në mirëqenien e familjeve dhe përgjithësisht në zhvillim, është theksuar në shumë komunikime të Bankës së Shqipërisë. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2018, Banka e Shqipërisë ka angazhuar burimet e saj në zhvillime, të cilat synojnë krijimin e parakushteve të nevojshme për kanalizimin sa më efikas të këtyre të ardhurave në ekonominë shqiptare.

Duke iu referuar nismave ndërkombëtare në fushën e remitancave, evidentohet rëndësia e reduktimit të kostove dhe rritja e efikasitetit të shërbimeve për dërgesat, duke nënkuptuar nevojën për ndërhyrje në tregun e pagesave me vlerë të vogël, si në vendet dërguese të remitancave, ashtu dhe në ato pritëse.

Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë, sikurse kemi theksuar edhe në fillesat e këtij bashkëpunimi, është angazhuar në një sërë projektesh, të cilat synonin analizimin e tregut vendas me qëllim identifikimin dhe adresimin e nevojave për ndërhyrje. Projektet në fjalë janë asistuar nga Banka Botërore dhe financuar nga SECO, dhe këtu përfitoj nga rasti t'i falënderoj edhe një herë këto institucione për kontributin dhe mbështetjen e tyre.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë dhe Komiteti Kombëtar i Sistemeve të Pagesave kanë miratuar dhe vënë në zbatim tashmë strategjinë kombëtare për tregun e pagesave me vlerë të vogël. Strategjia në fjalë synon krijimin e një tregu bashkëkohor e gjithëpërfshirës të pagesave me vlerë të vogël, të mbështetur nga infrastruktura të sigurta dhe efikase, si dhe nga një gamë e gjerë instrumentesh dhe shërbimesh të pagesave, që përmbushin nevojat e përdoruesve të aftë financiarisht për të kryer pagesa në të gjithë vendin. Duke shtuar në objektivat e Bankës së Shqipërisë edhe përfshirjen financiare, kjo strategji ka përcaktuar objektiva sasiorë mjaft ambiciozë duke synuar kështu dyfishimin e popullsisë që zotëron një llogari bankare (nga 38% në vitin 2014, në 70% në vitin 2022) dhe rritjen e numrit të pagesave elektronike për frymë (nga 4.3 në vitin 2016, në 10 në vitin 2022).

Por, për arritjen e këtyre objektivave vjen natyrshëm edhe nevoja për një plan veprimi konkret e të detajuar, i cili kërkon mbështetjen e të gjithë aktorëve të përfshirë në tregun e pagesave, si dhe ndërhyrje në shumë aspekte, ku mund të përmend:

përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ në zbatim;

zhvillimin dhe përmirësimin e infrastrukturave për shërbimet financiare;

zgjerimin e numrit dhe përdorimit të llogarive dhe shërbimeve të pagesave;

zgjerimin e pikave të aksesit të këtyre shërbimeve;

rritjen e edukimit, ndërgjegjësimit dhe përfshirjes financiare;

rritjen e volumeve të transaksioneve të procesuara nga sistemet e pagesave.

Pavarësisht faktit që strategjia është miratuar rishtazi në muajin qershor, hapa konkretë janë arritur në këtë drejtim ku mund të përmend hartimin e projektligjit "Për shërbimet e pagesave në Republikën e Shqipërisë", i cili transpozon direktivën e rishikuar të Bashkimit Evropian "Për shërbimet e pagesave" (PSD2). Miratimi dhe zbatimi i këtij projektligji vlerësohet të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në nxitjen e konkurrencës dhe inovacionit në fushën e pagesave me vlerë të vogël, duke promovuar kështu efikasitetin dhe reduktimin e kostove që mbart përdorimi i tyre. Për më shumë, projektligji vlerësohet të rrisë transparencën në shërbimet e ofruara nga tregu dhe në krijimin e një kuadri të konsoliduar për mbrojtjen e konsumatorit, një përbërës ky mjaft i rëndësishëm për tregun tonë. Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, projektligji synon edhe zgjerimin e ofrimit të shërbimeve nga bankat në të gjithë territorin (përfshirë dhe zonat rurale).

Përtej përmirësimeve ligjore, hapa të rëndësishëm janë shënuar edhe në kuadër të edukimit financiar. Këtu dëshiroj të theksoj nismën e ndërmarrë në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe të financuar nga SECO, për zbatimin e projektit Greenback 2 në qytetin e Beratit. Projekti konsiston në rritjen e përfshirjes dhe edukimit financiar të emigrantëve dhe familjeve të tyre, si dhe përdorimin e kanaleve sa më efikase në terma të kostove për dërgimin e fondeve.

Gjithashtu, me qëllim zgjerimin e njohurive të tregut në lidhje me remitancat, në muajin qershor, Banka e Shqipërisë ka publikuar botimin me titullin "Remitancat: Një mbështetje për zhvillim". Ky publikim, i gjithi i dedikuar remitancave, ofron një përqasje gjithëpërfshirëse të aspekteve të ndryshme të dërgesave në tregun vendas, ku mund të përmendim analizimin në nivel makro të remitancave dhe ndikimin e tyre në zhvillim, impaktin e këtyre dërgesave tek familjet, analizimin e infrastrukturës së tregut të remitancave në Shqipëri dhe nevojat për ndërhyrje, si dhe ofrimin e statistikave në lidhje me remitancat.

Një hap i rëndësishëm në kuadër të edukimit financiar është ndërmarrë edhe nga Shoqata Shqiptare e Bankave, e cila në muajin qershor ka nënshkruar me 8 organizata partnere, një memorandum bashkëpunimi për krijimin e Rrjetit Shqiptar për Edukimin Financiar dhe rritjen e bashkëpunimit e koordinimit ndërinstitucional në fushën e edukimit financiar.

Megjithatë, pavarësisht zhvillimeve që përmenda më parë, mbetet ende shumë për t'u bërë, dhe në këtë kuadër ftoj të gjithë të vijojmë përpjekjet me të njëjtin intensitet të treguar deri më tani për të modernizuar tregun vendas të pagesave.

Në periudhën afatmesme, Banka e Shqipërisë do të fokusojë përpjekjet në një sërë nismash, ku si më të rëndësishmet do të theksoja zhvillimet e mëtejshme ligjore dhe përmirësimet infrastrukturore.

Një hap i rëndësishëm në periudhën afatmesme konsiderohet hartimi i projektligjit "Për llogarinë e pagesave". Projektligji në fjalë do të transpozojë Direktivën e Bashkimit Evropian "Për llogarinë e pagesave" dhe do të nxisë transparencën, duke krijuar një regjistër publik për të gjitha komisionet e aplikuara nga institucionet dhe në një mënyrë lehtësisht të krahasueshme.

Njëkohësisht, gjatë kësaj periudhe, Banka e Shqipërisë do të angazhohet në një sërë zhvillimesh infrastrukturore, të cilat mbështesin përfshirjen financiare, reduktojnë kostot e përdorimit të këtyre instrumenteve dhe vlerësohet të kenë ndikim edhe në tregun e remitancave, kryesisht nga pikëpamja e marrësve të dërgesave dhe përdorimit të tyre. Këtu mund të përmendim krijimin e një platforme kombëtare për procesimin e pagesave në kohë reale (instant payment dhe për procesimin e pagesave me kartë). Këto platforma krijojnë kushtet për zhvillimin e shërbimeve inovative dhe me kosto të ulëta, si dhe synojnë segmente të tregut, të cilat krijojnë volume të bollshme, duke targetuar pagesat e institucioneve shtetërore dhe pagesat që qytetari shqiptar i kryen në përditshmërinë e tij.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, dëshiroj të falënderoj qeverinë shqiptare për rëndësinë e dhënë dhe mbështetjen e vazhdueshme, veçanërisht ministritë e saj, si Ministria e Diasporës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me të cilat Banka e Shqipërisë ka pasur një bashkëpunim të frytshëm deri tani, duke shprehur besimin se do të vijojmë me të njëjtat ritme përpjekjet e përbashkëta për përfshirjen sa më të shpejtë e të gjerë në ekonominë e vendit, të këtij faktori mjaft të rëndësishëm.

*** Fjala e Guvernatorit të BSH në takimin e dytë të nivelit të lartë për remitancat**

## HOROSKOPI

### DASHI
Në jetën sentimentale mund të keni ndonjë shqetësim të vogël. Por përgjithësisht do të jetë një ditë e qetë. Ne sektorin e financave mund të keni ndonjë përmirësim të lehtë.

### DEMI
Pritet të merrni lajme të mira në sektorin e financave. Në vendin e punës mund të përfshiheni nga disa debate që mund të degjenerojnë nëse nuk ruani qetësinë.

### BINJAKET
Parashikohet të jetë një ditë mjaft e mirë në aspektin fizik. Kjo gjendje do të pasqyrohet edhe ne aspektin shpirtëror. Shfrytëzojeni këtë ditë për të bërë investime afatgjata.

### GAFORJA
Kushtojini më shumë vëmendje gjendjes së përgjithshme shpirtërore. Këshilloheni të merreni me sport, joga apo të praktikoni ushtrime frymëmarrjeje për më shumë energji.

### LUANI
Një ditë e kaluar me njerëz të dashur dhe që sjellin energji pozitive te ju është një ditë perfekte. Edhe në sektorin e financave gjërat do të shkojnë mjaft mirë.

### VIRGJERESHA
Dita e duhur për të zgjidhur disa çështje të lëna pezull. Nëse po mendoni t'i realizoni ato, mos humbisni kohë, sepse nuk do të mungojë favorizmi planetar për të lindurit në këtë shenjë.

### PESHORJA
Po kaloni momente jo shumë optimiste, por situata do të përmirësohet nga pjesa e dytë e ditës. Kushtojini më shumë vëmendje përmirësimit të gjendjes shpirtërore.

### AKREPI
Ditë e mirë për vendime të rëndësishme që mund të ndryshojnë jetën tuaj. Aspekti planetar është mjaft pozitiv ndaj shfrytëzojeni për të realizuar projektet tuaja.

### SHIGJETARI
Disa takime surprizë mund të sjellin ide të reja në aspektin profesional. Nëse jeni duke menduar për hapjen e një biznesi, gjërat do t'ju ecin mbarë. Mund të keni oferta të reja pune.

### BRICJAPI
Mund të nisni një lidhje të re dashurie e cila parashikohet të zgjasë. Kjo gjë mund ta ndryshojë gjendje tuaj emocionale. Në punë jo gjithçka po ecën mirë.

### UJORI
Prej një kohe të gjatë nuk po arrini të gjeni veten në aspektin profesional. Duhet të reflektoni dhe njëkohësisht të këshilloheni me një person, i cili ka më shumë eksperiencë se ju.

### PESHQIT
Nëse nuk tregoni më shumë angazhim, asgjë nuk do të funksionojë si duhet. Gjithçka do ta arrini me shumë mund, por në fund rezultati do t'ju gëzojë shumë.

## PRESIDENTI I PARTIZANIT




### Demi: Barazimi i kënaqshëm, merkaton e bën drejtori

Presidenti i Partizanit, Gazment Demi, ka dhënë një prononcim të shkurtër për mediat pas përfundimit të sfidës me Kukësin, ku e cilësoi një rezultat të mirë barazimin, duke llogaritur rrjedhën që mori sfida. "Ashtu si shkoi ndeshja, mirë shkoi. Nuk ishte ndeshja për ta fituar një skuadër. Titulli? Ka kohë akoma për të, çfarë janë 5 pikë! Edhe 8 të ishim, përsëri njëlloj do ishte, akoma nuk ka mbaruar gjysma. Po mirë, do të ecim në janar", vijoi ai duke lënë gjithçka hapur rreth përforcimeve që priten në merkato nga të kuqtë. "Ato i di stafi teknik, drejtori", tha duke u larguar Demi.

## PRESIDENTI I KUKËSIT



### Gjici: Doja fitoren, sjell dy lojtarë në dhjetor

Presidenti i Kukësit, Safet Gjici, foli për mediat pas ndeshjes kundër Partizanit, ku pranoi se Kukësi do të bëjë ndërhyrje në janar. "Do isha i kënaqur me fitoren, por nuk na deshi fati. Patjetër që do të ketë ndërhyrje në janar. Kam përshtypjen se brenda dhjetorit do të nënshkruajmë me 2 lojtarë që do të bëjnë diferencën. Ishte ndeshje në transfertë, ndonëse ne të gjitha takimet i luajmë në transfertë, ndaj jam i kënaqur edhe me barazimin. Ne jemi brenda objektivave dhe dihet se duam të fitojmë titullin kampion. Kemi bërë mirë deri më tani dhe të vazhdojmë kështu", - u shpreh Gjici.

Bardhi e Rexhinaldo shpërdorojnë mundësi shënimi. Në pjesën e dytë ekipet më shumë mbrohen



Jeton Selimi

# Frikë për të mos humbur, Partizani e Kukësi barazojnë

## *Në "Selman Stërmasi" mbyllet çdo gjë me shifrat 0-0*

Ka përfunduar pa fitues kryesfida e javës së 17 të Kategorisë Superiore, ajo mes Partizanit dhe Kukësit, e zhvilluar në stadiumin "Selman Stërmasi" të kryeqytetit. Nën reshjet e shiut që shoqëruan takimin në pjesën më të madhe të lojës, si kryesuesit e kampionatit, ashtu edhe verilindorët dhuruan një ndeshje të luftuar shumë thuajse në çdo sektor të fushës. Gjithsesi, frika për të mos humbur ishte ajo që triumfoi përballë dëshirës për fitore, ndaj asnjë prej skuadrave nuk bëri mjaftueshëm për të dërguar topin në rrjetë, duke bërë që sfida të mbyllej në barazim 0-0. Partizani rrezikoi i pari në dy momente me Bardhin, ndërsa Kukësi pati një mundësi të mirë në pjesën e parë, me Reginaldon që i shkoi pranë golit, pas një gjuajtjeje me kokë. Gega përforcoi sulmin në pjesën e dytë, por pa rrezikuar seriozisht kuadratin e Frashërit, me Kukësin që gjithashtu u mbrojt me kujdes. Vërshëllima e trefishtë e gjyqtarit kryesor Enea Jorgji bëri që skuadrat të ndajnë nga një pikë, rezultat që lë të kënaqura të dyja skuadrat, pasi Partizani mbetet në krye të renditjes, tashmë me 36 pikë, ndërsa Kukësi merr vendin e dytë me 31 pikë dhe mbi të gjitha nuk humb në fushën e rivalit direkt për titull.




**GEGA: PARTIZANI PARAGJYKOHET**

Trajneri i Partizanit, Skënder Gega ka folur për "Supersport" pas barazimit 0-0 kundër Kukësit, ku u shpreh: "Çdo mungesë, në pozicionin që jemi dhe momentin që jemi, pa përjashtuar moshën, besoj se ndjehet. "Jam jashtëzakonisht i kënaqur për atë që dhamë në fushë, luajtëm me një rival për t'u respektuar. Me gjithë gabimet tona, morëm maksimumin. Jemi përpara një fakti që të gjithë do të korrigjohemi dhe të bëhemi gati të kemi më shumë potencial dhe mësojmë nga gabimet. Partizani është i njohur për historinë, është i paragjykuar para kampionatit, sot jemi këtu, kam respekt ndaj kujtdo dhe një ndeshje e mirë ndaj Partizanit është benefit për këdo. Ne luajtëm me Kukësin, ekip kampion".

**SUPERLIGA**

| | | |
|---|---|---|
| *TË PREMTEN* | | |
| Partizani - Kukësi | 0-0 | |
| *TË SHTUNËN* | | |
| Laçi - Tirana | 14:00 | |
| Flamurtari - Kamza | 17:00 | |
| *TË DIELËN* | | |
| Kastrioti - Teuta | 14:00 | |
| Skënderbeu - Luftëtari | 17:00 | |

*RENDITJA*

| Skuadra | N | P |
|---|---|---|
| Partizani | 17 | 36 |
| Kukësi | 17 | 31 |
| Skënderbeu | 16 | 30 |
| Teuta | 16 | 29 |
| Laçi | 16 | 26 |
| Flamurtari | 16 | 25 |
| Tirana | 16 | 14 |
| Luftëtari | 16 | 13 |
| Kamza | 16 | 12 |
| Kastrioti | 16 | 10 |

**CUNGU: HOXHA NA MOHOI FITOREN**

Trajneri i Kukësit, Armando Cungu foli për "Supersport" pas ndeshjes kundër Partizanit, ku u shpreh jo shumë i kënaqur me marrjen e një pikë nga kjo sfidë. Për këtë barazim, Cungu bën "fajtor" portierin Hoxha, duke e quajtur të shkëlqyer: "Normalisht që dëshira e çdokujt është të fitojë ndeshjen, ishte objektivi ynë. Dëshirën dhe mundësitë i treguam në fushë ku ishim afër fitores. Nuk po luanim me ekip dosido, por me kryesuesin. E dinim që nuk ishte e lehtë, por jam i kënaqur me atë që dhanë djemtë. Për mosmarrjen e tri pikëve, faktor ishte edhe Hoxha, i cili ishte në ditën më të mirë të kampionatit. Dëshira dhe objektivi ishte për të marrë tri pikë, për ta provuar. Fakti që iu afruam nga 12 në 5 pikë kundërshtarit, një trepikësh do të ishte shumë i ngrohtë për ne. Por nuk ka pse të mos jem pjesërisht i kënaqur me një pikë, pasi luanim ndaj vendit të parë, në fushën e tij".

## KREU I GJIROKASTRITËVE

### Tavo takon ekipin, garanton financat

Skuadra e Luftëtarit është në kulmin e përgatitjeve për transfertën që do të zhvillojë në Korçë me Skënderbeun. Bluzinjtë kanë një nga transfertat më të vështira, e megjithatë skuadra është duke u përgatitur dhe vlerësuar maksimalisht kundërshtarin e radhës. Por, në seancën e djeshme stërvitore siç edhe mëson "Vipsport", ka qenë i pranishëm edhe presidenti i skuadrës, Grigor Tavo, i



cili ka takuar jo vetëm stafin, por edhe skuadrën. Tavo ka kërkuar nga skuadra përqendrim maksimal në dy ndeshjet e radhës, pasi financat i kanë të garantuara. Trajneri Gentian Mezani, nga ana tjetër ka zhvilluar një stërvitje të plotë, ndërsa pozitive është se skuadra do të jetë e plotë në sfidën e radhës në Korçë, ndryshe nga takimet pasardhëse, ku thuajse në çdo ndeshje Luftëtari ka pasur probleme mungesash nga dëmtimet apo kartonët.

## TRAJNERI I INTERIT

### Spaleti: Meritoj të gjitha kritikat

Para mediave, përpara takimit me Udinezen, trajneri Luçiano Spaleti shprehet se Interi nuk duhet të prishë atë që ka ndërtuar deri më tani me kaq shumë mund dhe se i pranon kritikat për humbjet e ekipit të tij, që sollën edhe eliminimin nga Liga e Kampionëve.

**KRIZA**

"Nuk mendoj se jemi në krizë. Nëse shikon rezultatet, mund ta krijosh këtë ide, por po të shikosh ndeshjet tona, do të kuptosh se gjithçka është vendosur nga gabime shumë të vogla. Nuk është si kriza që pësuam në mes të sezonit të kaluar. Është thelbësore që skuadra të reagojë menjëherë".

**AKUZAT**

"Më është krijuar mendimi se disa njerëz kërkojnë të shkatërrojnë atë që kemi punuar prej kaq shumë kohësh. Nuk është nevoja të hedhim çdo gjë poshtë. Rrugëtimi i Interit vazhdon dhe për këtë duhet të punojmë. Është e qartë që të gjitha kritikat për mua janë të drejta. Nuk është nevoja të merreni me lojtarët. Ata po bëjnë gjithçka siç duhet dhe më kanë treguar se janë të gatshëm të punojnë për ta çuar Interin aty ku duhet. Sigurisht një pjesë e kritikave ka qenë brutale, por kritikat e bëra siç duhet mund të na ndihmojnë për të parë siç duhet ku çalojmë".


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISË, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al